

**VËLLIMI XX/KORRIK-SHTATOR/ 2022**

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS**

**BULETINI ZYRTAR**

**PËRMBAJTJA**

Nr. 895, Datë 05.07.2022 .....	4
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PRODHIMIT/IMPORTIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË ÇIMENTOS”.	
Nr. 896, Datë 05.07.2022 .....	6
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË VENDIMIT NR. 703, DATË 06.08.2020 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJET VODAFONE ALBANIA, TELEKOM ALBANIA DHE ALBTELECOM”.	
Nr. 897, Datë 05.07.2022 .....	14
“MBI AUTORIZIMIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C. DHE FILIALIT TË SAJ NGA SHOQËRIA YILDIRIM KOSOVO MINING INVESTMENTS L.L.C.”.	
Nr. 898, Datë 15.07.2022 .....	18
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VARGON D.O.O NGA SHOQËRIA PIPELIFE INTERNATIONAL GMBH”.	
Nr. 899, Datë 15.07.2022 .....	21
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SIKKIM HYDRO POWER VENTURES LTD. NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS”.	
Nr. 900, Datë 15.07.2022 .....	24
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME KONISPOL SHA”.	
Nr. 901, Datë 29.07.2022 .....	27
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË VISHNUPRIYA FARMS PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS”.	
Nr. 902, Datë 29.07.2022 .....	31
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME KUKËS SHA”.	

Nr. 903, Datë 29.07.2022 .....	34
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME BULQIZË SHA”.	
Nr. 904, Datë 29.07.2022 .....	38
“PËR VAZHDIMIN E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MIDIS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR KARTONIN JESHIL”.	
Nr. 905, Datë 29.07.2022 .....	46
“PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE SWIXX BIOPHARMA AG DHE SANOFI-AVENTIS GROUPE”.	
Nr. 906, Datë 29.07.2022 .....	51
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN KU USHTROJNË VEPRIMTARINË SFJB”.	
Nr. 907, Datë 09.09.2022 .....	58
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT MBI SHOQËRINË VIANODE AS NGA SHOQËRITË ELKEM ASA, HYDRO ENERGI INVEST AS DHE ALTOR FUND V (NR. 1 DHE NR. 2) AB.	
Nr. 908, Datë 09.09.2022 .....	62
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË VISHNUPRIYA FARMS PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRITË STATKRAFT IH HOLDINGS AS DHE STATKRAFT INDIA PRIVATE LIMITED”.	
Nr. 910, Datë 26.09.2022 .....	66
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SIKKIM HYDRO POWER VENTURES LTD. NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS”.	

**VENDIM**

**Nr. 895, Datë 05.07.2022**

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PRODHIMIT/IMPORTIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË ÇIMENTOS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e hetimit paraparak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”,

**VËREN SE:**

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut të prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shrebbërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.
2. Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për monitorimin, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe Instituti i Statistikave.
3. Nga të dhënat e administruara gjatë monitorimit rezulton se çmimi i shitjes së çimentos nga ndërmarrjet importuese dhe prodhuese ka pasur një tendencë rritjeje të fortë duke arritur drejt një çmimi rreth 115-120 euro/ton, thuajse të njëjtë për të gjithë konkurrentët në tregun e çimentos, si ato të importit ashtu dhe të prodhimit të brendshëm. Gjithashtu nga monitorimi konstatohet se ky ndryshim i çmimeve ka ndodhur në të njëjtën periudhë për ndërmarrjet importuese dhe prodhuese.
4. Prodhimi i çimentos vendase zë edhe vendin kryesor, konkretisht për vitin 2021, referuar xhirove të ndërmarrjeve me rreth 85% të totalit të shitjeve dhe një pjesë e konsiderueshme e prodhimit të tre fabrikave shkon për eksport.
5. Tregu i prodhimit të çimentos është një treg shumë i përqendruar me pak ofrues. Produkti që ofrojnë konkurrentët është një produkt homogjen me një shkallë të lartë transparence, gjë e cila mund të çojë drejt një sjellje të mundshme bashkërenduese ndërmjet konkurrentëve në këtë treg.
6. Tregu i importit të çimentos rifuxho është gjithashtu një treg i përqendruar, pasi janë vetëm një numër shumë i vogël ndërmarrjesh të cilat importojnë këtë produkt.

7. Për sa më sipër, çmimet e përafërta të shitjes së ndërmarrjeve prodhuese dhe importuese, rritja në të njëjtën periudhë, struktura e përqendruar e tregut, homogjeniteti i produktit, janë elementë të cilët mund të çojnë drejt një sjelljeje të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve, sjellje e cila mund të përbëjë një kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2021 deri në 30 Qershor 2022.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 896, Datë 05.07.2022

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË VENDIMIT NR. 703, DATË 06.08.2020 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJET VODAFONE ALBANIA, TELEKOM ALBANIA DHE ALBTELECOM”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbyllja e procedurës së monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 703, datë 06.08.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraparak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom..

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

### VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 703, datë 06.08.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraparak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom”, ka vendosur:
  - I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraparak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
  - II. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve.
    1. **Për ndërmarrjen Vodafone Albania:**
      - a. Rritje e transparencës mbi produktet e reja/ndryshuara që hidhen në treg;
      - b. Akses për të gjithë;
      - c. Më shumë internet data në celular për të gjithë - paketat e solidaritetit dixhital për COVID19;
      - d. Përputhshmëria e praktikave të ndryshimit të çmimit me ligjin për konkurrencën.

**2. Për ndërmarrjen Telekom Albania:**

- a. Garantimi i pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat rregullatore në fuqi, veçanërisht atyre që rregullojnë fushën e tarifave të aplikuara ndaj konsumatorëve;
- b. Ruajtja e transparencës kundrejt konsumatorëve;
- c. Ofrimi i një game më të gjerë çmimesh, të përballeshme për tregun shqiptar, sipas treguesve ekonomikë të Shqipërisë; g. Promovimi fuqishëm dhe zbatimi i strategjive me në qendër konsumatorin;
- d. Të qenit proaktiv dhe mbështetës kundrejt sugjerimeve dhe nevojave që adresohen nga klientët;
- e. Njoftimi i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ndryshimet e çmimeve.

**3. Për ndërmarrjen Altelecom:**

- a. Mundësi aksesit për përdoruesit me të ardhura të ulta;
- b. Më shumë internet "mobile data" për të gjithë - solidaritet për COVID-19;
- c. Bonus solidariteti për çdo rimbushje të kartës SIM për solidaritetin e gjithanshëm;
- d. Informimi i Publikut.

III. Ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom kanë detyrimin ligjor të mos bëjnë marrëveshje dhe/ose praktika të bashkërenduara, të cilat kanë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht:

- a. të caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;
- b. të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; c. të ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
- c. në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- d. të kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penalitetin përkatës.

V. T'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare që hedhja e paketave të reja nga secila ndërmarrje në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, të shoqërohet me një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasimor në zbatim të Rregullores nr. 27/2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".

VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom.

2. AK ka kryer monitorimin e zbatimit të kushteve dhe detyrimeve për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, One Telecommunications SHA, Altelecom SHA si dhe ka bashkëpunuar me AKEP në kuadër të pikës V të dispozitivit të vendimit.
3. AK, për realizimin e këtij monitorimi ka kryer korrespondencën, si më poshtë vijon:

- AK me shkresën nr. 92/59 prot., datë 15.12.2020 “Kërkesë për informacion”, drejtuar AKEP ka kërkuar informacionin lidhur me zbatimin e pikës (V) të VKK nr. 703, datë 06.08.2020;
  - AKEP me shkresën nr. 270/7 prot., datë 23.12.2020 (protokolluar pranë AK me nr. 92/61 prot., datë 28.12.2020) “Mbi kërkesën për informacion” ka informuar mbi raportin që publikon në faqen zyrtare si dhe rregullohet nga AKEP tregu me pakicë.
  - AK me shkresën nr. 92/83 prot., datë 10.03.2021 “Kërkesë për informacion”, drejtuar AKEP ka kërkuar informacionin në lidhje me paketat e ofruara nga operatorët e telefonisë celulare, me parapagesë dhe paspagesë (kontratë), për periudhën pas daljes së VKK nr. 703, datë 06.08.2020;
  - AKEP me shkresën nr. 720/1 prot., datë 24.03.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 157/1 prot., datë 24.03.2021) “Mbi kërkesën për informacion” ka informuar në lidhje me tarifrat dhe paketat e reja të implementuara nga operatorët celularë; - AKEP me shkresën nr. 1299 prot., datë 14.05.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 169/8 prot., datë 17.05.2021) “Dërgim informacioni”, ka informuar në lidhje me raportin e tarifave të paketave të shërbimeve celulare të njoftuara në AKEP dhe përmbledhjen e planeve tarifore të shërbimit fiks për sipërmarrësin Vodafone Albania SHA;
  - Ndërmarrjet Vodafone Albania, One Telecommunications SHA, Albtelecom SHA, rast pas rasti, kanë depozituar pranë AK planet e reja tarifore me parapagesë dhe paspagesë, si dhe ndryshimet e tyre.
4. AK, për realizimin e këtij monitorimi ka kryer dhe monitorime pranë degëve qendrore të ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA, ONE Telecommunications SHA dhe Albtelecom SHA duke mbajtur procesverbale përkatëse gjithashtu janë monitoruar dhe faqet zyrtare për secilën ndërmarrje.
5. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjet Vodafone Albania SHA, ONE Telecommunications SHA, Albtelecom SHA, konstatohet si më poshtë vijon:

**i. Lidhur mbi angazhimet e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA:**

*a. Angazhimi nr. 1: Rritje e transparencës mbi produktet e reja/ndryshuara që hidhen në treg;*

Në kuadër të informacionit të mbledhur si rezultat i monitorimeve dhe shkresave të administruara, është konstatuar se Vodafone Albania ka rritur transparencën duke përdorur kanale të ndryshme njoftimi për konsumatorët si: faqja zyrtare, mjete të komunikimit publik (p.sh. gazeta), mjete të tjera 4 SAMI FRASHËRI Street, No. 4, 4th Floor, Tirana, ALBANIA 1004, +355 (0) 42234504, [caa.gov.al](mailto:caa.gov.al), [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al) dixhitale (Facebook, Instagram), por gjithashtu edhe njoftime të drejtpërdrejta tek klientët përmes SMS. Afishimet në dyqane vazhdojnë të mbeten një kanal tjetër komunikimi.

*b. Angazhimi nr. 2: Akses për të gjithë;*

Vodafone Albania ka hedhur në treg paketa me çmime ekonomike 200 dhe 500 lekë me qëllim për të siguruar akses në shërbime për të gjitha grupet. Gjithashtu për uljen e rrezikut për përhapjen e COVID19 te përfaqësuesit e shitjeve dhe klientëve, Vodafone ka ndërmarrë iniciativën për të nxitur dhe për t'i dhënë një shtysë më tepër përdorimit të kanaleve dixhitale në krahasim me pikat fizike. Njëpërmjet përdorimit të kanaleve dixhitale është konstatuar se favorizohet konsumatori duke vijuar me përfitime si bonuse apo dhurata që i ofrohen klientëve në mënyrë të vazhdueshme.



*c. Angazhimi nr. 3: Më shumë internet data në celular për të gjithë - paketat e solidaritetit dixhital për COVID-19;*

Vodafone për të mbështetur të gjithë grupet e klientëve me parapagesë dhe me kontratë gjatë kësaj periudhe ka dhuruar 1 muaj komunikim falas për mjekët; 10 GB falas për çdo rimbushje mbi 800 lekë, ka ofruar çmime promocionale për gjithë pajtimtarëve të rinj dhe atyre të portuar në rrjetin Vodafone me bonus 3.5 GB internet; paketa shtesë interneti 5GB dhe 6GB duke ulur me 16% dhe 11% çmimin për GB, ka lancuar një portofol të ri me paketat me parapagesë i cili përfshin dhe 50% më shumë njësi data, ka rritur njësitë data për paketat roaming për pajtimtarët me parapagesë dhe me paspagesë të planeve Vodafone Next dhe Next+.

*d. Angazhimi nr. 4: Përputhshmëria e praktikave të ndryshimit të çmimit me ligjin për konkurrencën.*

Vodafone ka vepruar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës si dhe vendimin nr. 703, datë 06.08.2020. Praktikrat e ndryshimit të çmimeve janë rezultat i një procesi gjithëpërfshirës si: dinamikat e tregut, sjellja e konsumatorit; performanca e kompanisë; politikrat e brendshme komerciale si dhe analizat financiare të marketingut.

## **ii. Lidhur mbi angazhimet e ndërmarrjes ONE Telecommunications SHA:**

*a. Angazhimi nr. 1: Garantimi i pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat rregullatore në fuqi, veçanërisht atyre që rregullojnë fushën e tarifave të aplikuara ndaj konsumatorëve;*

ONE Telecommunications, sipas informacionit të mbledhur si rezultat i monitorimeve dhe shkresave të administruara, ka rezultuar se ka vepruar konform kuadrit rregullator në fuqi në lidhje me përcaktimin e politikave të saj tarifore, ndryshimeve të tarifave kundrejt përdoruesve fundorë. Për çdo plan të ri tarifor, nga ana e tyre janë kryer njoftimet përkatëse pranë AKEP, 15 ditë përpara hedhjes në treg të këtyre planeve tarifore apo ndryshimeve të çmimeve apo elementë të tjerë të paketave, në përputhje me parashikimet e Rregullores së AKEP nr. 27, datë 21.09.2012, i ndryshuar “Mbi Publikimin e informacionit për tarifrat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

*b. Angazhimi nr. 2: Ruajtja e transparencës kundrejt konsumatorëve;*

One Telecommunications është treguar transparent për të gjitha produktet, paketat dhe planet që ofron. Në faqen zyrtare gjendet çdo detaj lidhur me çmimet, benefitet, mënyra si konsumohet, destinacionet etj. Përmes mesazheve njoftuese, klienti merr informacion lidhur me përfitimet, njësitë e mbetura të paketave apo planeve, vlefshmërinë e tyre. Këtë informacion e merr në çdo dyqan, në aplikacion ose duke telefonuar pa pagesë numrin 142 (kujdesi i klientit).

*c. Angazhimi nr. 3: Ofrimi i një game më të gjerë çmimesh, të përballueshme për tregun shqiptar, sipas treguesve ekonomikë të Shqipërisë;*

One Telecommunications ka ofruar një gamë të gjerë çmimesh duke mbuluar nevojat e të gjithë segmenteve. Paketat One Unlimited me Parapagesë, fillojnë nga 500 lekë, e deri në 2000 lekë. Megjithëse në momentin e re-branding, kompania hodhi në treg paketa të reja, nuk mori vendim të menjëhershëm për heqjen nga tregu të paketave ekzistuese, kjo për faktin se në portofolet e vjetra ka ende paketa që preferohen nga klientët e saj. Vendimi për heqjen nga tregu i paketave të vjetra do të merret vetëm pasi të shohin që klientët nuk do të jenë të interesuar për ato. Planet me kontratë fillojnë që nga çmimi 400 lekë, dhe shkojnë deri në 2030

lekë, duke përmbushur nevojat e bazës së gjerë të abonentëve në One Telecommunications.

*d. Angazhimi nr. 4: Promovimi fuqishëm dhe zbatimi i strategjive me në qendër konsumatorin;*

One Telecommunications ka plotësuar portofolin e produkteve me me në fokus vetëm konsumatorin si: telefona me këste të përballueshme, interneti në shtëpi, u investua në rrjet, në përmirësimin dhe modernizimin e tij vetëm që klienti të përjetojë një eksperiencë gjithnjë e më të mirë. Në fundvit, One Telecommunication ofroi tek konsumatorët çmime më të ulta (zbritje në telefona, 50% zbritje në HomeNet), me më shumë benefite (3X më shumë internet).

*e. Angazhimi nr. 5: Të qënit proaktiv dhe mbështetës kundrejt sugjerimeve dhe nevojave që na adresohen nga klientët tanë;*

One Telecommunications çdo 3 muaj ka kryer sondazhe/pyetësorë për të kuptuar nevojat e klientëve. Rezultatet e tyre ndihmojnë kompaninë që të përmirësojë produktet ekzistuese dhe për të krijuar produkte të reja. Partnerët e shitjeve, rrjetet sociale, kujdesi i klientit janë kanale të tjerë ku mbështetet për t'u përmirësuar dhe për të ofruar në momentin e duhur atë që kërkon tregu.

*f. Angazhimi nr. 6: Njoftimi i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ndryshimet e çmimeve.*

ONE Telecommunications ka njoftuar periodikisht Autoritetin e Konkurrencës për të gjitha çmimet e reja të aplikuara apo ndryshime të paketave ekzistuese si dhe të elementeve të tjerë përkatës në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 703, datë 06.08.2020 "Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom".

### **iii. Lidhur mbi angazhimet e ndërmarrjes Albtelecom SHA:**

*a. Angazhimi nr. 1: Mundësi aksesit për përdoruesit me të ardhura të ulta;*

Albtelecom sipas informacionit të mbledhur si rezultat i monitorimeve dhe shkresave të administruara, ka rezultuar se ka hedhur në treg që nga muaji shtator 2020 e në vijim me ofertë portabiliteti ku u garanton klientëve të rinj për 12 muaj, një paketë me çmimin 400 lekë, e vlefshme për 30 ditë dhe u ofron internet pa limit nga të cilat 50 GB me shpejtësi të lartë.

*b. Angazhimi nr. 2: Më shumë internet "mobile data" për të gjithë - solidaritet për COVID-19;*

Albtelecom duke filluar nga data 7 tetor 2020, ka hedhur në treg paketat e reja, me në fokus internetin pa limit me shpejtësi të reduktuar, dhe në shumë paketa është dyfishuar interneti si dhe hedhja në treg e paketës 400 lekë me 50 GB internet. Studentët gjithashtu kanë përfituar internet falas për lundrimin në platformat e mësimin online.

*c. Angazhimi nr. 3: Bonus solidariteti për çdo rimbushje të kartës SIM për solidaritetin e gjithanshëm;*

Albtelecom ka aplikuar shërbime me volume interneti dhuratë për rimbushje e aktivizime nga kanalet digjitale si BKT dhe aplikacioni Profili im Për çdo rimbushje nga aplikacioni "Profili Im", Albtelecom ofron: 25 GB internet bonus për rimbushjen e parë; 2 GB internet bonus për çdo rimbushje nga 300 - 499 lekë; 5 GB internet bonus për çdo rimbushje nga 500 – 999 lekë; 15 GB internet bonus për çdo rimbushje nga 1000 lekë e më shumë.

Gjithashtu duke rimbushur numrin ALBtelecom Mobile nga kanalet alternative të BKT-së (ATM, Dega

Internet, apo BKT Smart) përfiton 2 GB internet dhuratë. Dhurata prej 2 GB mund të konsumohet brenda 30 ditësh nga momenti i rimbushjes dhe mund të përfitohet sa herë që kryen një rimbushje prej 500 Lekësh e sipër, nëpërmjet ATM-ve, Degës Internet, apo BKT Smart.

d. *Angazhimi nr. 4: Informimi i Publikut.*

Albtelecom ka informuar publikun përmes: AKEP, informacion nga aplikacioni në përdorim nga abonentët e tyre si Profili IM, etj, në të gjithë llogaritë e Albtelecom në rrjetet sociale (Instagram, Facebook, Twitter, etj), si dhe nëpërmjet faqes zyrtare së ndërmarrjes <https://www.albtelecom.al/al/individuale/>.

#### 6. AKEP sipas informacionit të depozituar në AK:

- Ka informuar se vijon të kryejë studime lidhur me konkurrueshmërinë e strategjive tregtare të operatorëve të rrjeteve celulare, në funksion të analizave të tregjeve përkatëse nën rregullim.
  - Në zbatim të nenit 12 të Rregullores nr. 27/12, i ndryshuar, shprehet se ka monitoruar paketat e lançuara nga operatorët që ofrojnë shërbime mobile në Shqipëri, të cilat më pas publikohen në një seksion të veçantë në faqen zyrtare në internet. Ky raport përmban një informacion të përgjithshëm mbi tarifatat dhe përditësimet e tyre të herëpashershme në funksion të transparencës dhe ofrimit të sa më shumë mundësive për zgjedhje nga konsumatorët. *Megjithatë, krahasimi i raporteve cilësi/çmim në tregun e shërbimeve celulare me pakicë, AKEP shprehet se ky treg nuk rregullohet nga AKEP, dhe mbetet jashtë detyrave të tij funksionale.*
  - Bazuar në raportin e fundit të publikuar AKEP shprehet se operatorët celularë ofrojnë një larmishmëri të gjerë paketash duke synuar përshtatjen me kërkesat dhe preferencat konsumatore. Gjatë vitit 2020, të tre operatorët mobile kanë ri-dizenuar paketat e tyre duke ofruar edhe paketa me çmime më të ulta të cilat arrijnë deri në 400 lekë për 30 ditë, por edhe paketa me çmime të njëjta ose të rritura në të cilat ofrojnë njësi komunikimi më shumë se në paketat pararendëse, kryesisht internet dhe minuta ndërkombëtare. Në ndryshim nga periudhat e mëparshme është vërejtur ofrim i shërbimit të internetit pa limit, pas përfundimit të njësisive të përcaktuara në paketë, por me shpejtësi interneti më të reduktuar.
  - Ka dërguar (në format CD) informacionin nga operatorët e telefonisë celulare të paraqitur në AKEP mbi paketat e ofruara për pajtimtarët me parapagesë dhe me kontratë, përfshirë të gjithë elementët e përmbajtjes së tyre, datat e njoftimit në AKEP, si dhe datat e hedhjes në treg, për periudhën 06.08.2020 – 23.03.2021.
  - Ka dërguar raportin të cilin e publikon dhe në faqen e tij “Tarifat e shërbimit nga rrjete celulare në Shqipëri” të muajin maj 2021 (*i cili gjendet i publikuar në faqen e internetit <https://www.akep.al/2018/11/17/tarifatat-3/>*) dhe përmbledhjen e planeve tarifore të shërbimit fiks për sipërmarrësin Vodafone Albania SHA të përditësuar edhe me periudhën Prill 2021.
  - Ka dërguar informacion të plotë mbi paketat e njoftuara për muajin nëntor 2021 e në vijim, nga operatorët e telefonisë celulare dhe fikse me parapagesë si edhe me kontratë, së bashku me të gjithë elementët e përmbajtjes së tyre, datat e njoftimit në AKEP dhe datat e hedhjes në treg.
7. AK ka vijuar me monitorimin e zbatimit e këtij vendimi, për të gjithë periudhën e angazhimeve të marra nga ndërmarrjet Vodafone Albania, One Telecommunications dhe Albtelecom.
8. Gjatë kësaj periudhe, ka patur disa ndryshime në lidhje me ndërmarrjet të cilat kanë marrë angazhimet sa më sipër.

9. Në datën 27/07/2020 përmes çështjes nr. CN-556023-07-20n pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit u depozituan nga ndërmarrja Telekom Albania me nipt: J61814094Ë aktet për ndryshimin e emrit tregtar të subjektit. Emri i subjektit i cili ishte Telekom Albania, tashmë u ndërrua në One Telecommunications, me po të njëjtin nipt. Kështu, subjekti do referohet në vijim me emrin tregtar One Telecommunications.
10. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.542 prot., datë 22.12.2021, “Konfirmim i depozitimit të dokumenteve”, ku jemi njoftuar mbi shitjen e 80.27% të kapitalit aksionar të shoqërisë Albtelecom SHA tek shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag. 4iG Nyrt nuk ka asnjë aktivitet dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.
11. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zotëron shoqëria Albtelecom SHA në treg.
12. Kështu në vijim, pranë Autoritetit të Konkurrencës përmes shkresës nr. 60 prot., datë 20.01.2022, jemi njoftuar mbi transaksionin e kryer i cili konsiston me blerjen e 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.
13. Shoqëria 4iG Nyrt synon që, nëpërmjet përfutimit të kontrollit edhe të operatorit One Telecommunications (pas marrjes së kontrollit të shoqërisë Albtelecom SHA), do të ketë mundësinë të mëdha menaxhimi dhe investimi, duke eliminuar teprica të konsiderueshme të krijuara nga mbivendosja e infrastrukturës si dhe duke harmonizuar shpenzimeve operacionale dhe investimet në kapital. Kombinimi i dy infrastrukturave do mundësojë implementimin e një platformë "rrjeti 5G", me qëllim krijimin e rrjetit më të mirë dhe më të fuqishëm kryesues 5G, jo vetëm brenda grupit të ri rajonal të 4iG (Mal i Zi dhe Shqipëri) por edhe në të gjithë Ballkanin. Shoqëria synon zëvendësimin e teknologjisë Huawei të përdorur nga operatori Albtelecom me rrjetet Clean Network, iniciativë e ndërmarrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe e përkrahur nga Qeveria Shqiptare, për sigurimin e rrjeteve të sigurta në terma afatgjatë.
14. Mbështetur mbi relacionin të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi vlerësimin paraprak të njoftimit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD (ATI AD) nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt), Komisioni i Konkurrencës konstatoi se transaksioni i propozuar pritet të sjellë bashkim mes dy operatorëve në tregun celular (One Telecommunications dhe Albtelecom), duke reduktuar numrin e operatorëve celularë në 2, (Vodafone dhe operatori i bashkuar). Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, i cili mund të krijojë pozitë dominuese të palëve në marrëveshje dhe mund të sjellë mbivendosje të aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar.
15. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 869, datë 08.03.2022 “Mbi Përfutimin e Kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag”, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG, me disa kushte dhe detyrime, të cilat sipas vendimit do të monitorohen në dy vitet e ardhshme.

16. Në këto kushte, me blerjen e ndërmarrjeve Albtelecom dhe One Communications nga shoqëria 4iG Nyrt, sipas njoftimit të përqendrimeve të përshkruara sa më sipër, vlerësohet se kemi të bëjmë me një ndryshim të tërësishëm të strukturës së tregut.
17. Sipas informacionit të monitorimit pranë degëve qendrore, faqeve zyrtare të ndërmarrjeve Vodafone Albania, One Telecommunications dhe Albtelecom, si dhe administrimit të informacionit në AK nga këto ndërmarrje, rezulton se kanë përmbushur kushtet dhe detyrimet sipas dispozitivit të VKK nr. 703, datë 06.08.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom”.
18. Në kuadër të zbatimit të rekomandimit të pikës “V” të dispozitivit të VKK nr. 703, datë 06.08.2020, rezulton se AKEP në dokumentin e dhjetor 2020 dhe të maj 2021 “Tarifat e shërbimit nga rrjete celulare në Shqipëri”, nuk ka realizuar një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasues për ndryshimet e kryera në paketat standarde nga tre operatorë celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare sipas përcaktimeve të nenit 8 dhe 12 të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”. AKEP me shkresën nr. 1299 prot., datë 14.05.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 169/8 prot., datë 17.05.2021) “Dërgim informacioni”, është shprehur se tregu i shërbimeve celulare me pakicë, është treg që nuk rregullohet nga AKEP dhe mbetet jashtë detyrave të tij funksionale.
19. Si përfundim, sa më sipër, duke qenë në kushtet ku struktura e tregut ka ndryshuar, monitorimi i tregut të shërbimeve celulare do të vijojë në kuadër të pikës III të dispozitivit të vendimit nr. 869, datë 08.03.2022 “Mbi Përfundimin e Kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag”.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të vendimit nr. 703, datë 06.08.2020 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.”
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 897, Datë 05.07.2022**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C. DHE FILIALIT TË SAJ NGA SHOQËRIA YILDIRIM KOSOVO MINING INVESTMENTS L.L.C.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Newco Ferronikeli Complex LLC dhe filialit të saj, nga shoqëria Yildirim Kosovo Mining Investments L.L.C.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Newco Ferronikeli Complex LLC dhe filialit të saj nga shoqëria Yildirim Kosovo Mining Investments L.L.C.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Newco Ferronikeli Complex LLC dhe filialit të saj, nga shoqëria Yildirim Kosovo Mining Investments L.L.C.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh”, palët janë:

**Pala blerëse:** Yildirim Kosovo Mining Investment L.L.C., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, e krijuar me qëllim të veçantë (SPV) për realizimin e këtij transaksioni.

Yildirim Kosovo Mining Investment L.L.C. zotërohet plotësisht nga Yildirim International Mining Investments B.V., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti blerjen, mbajtjen dhe disponimin e pjesëmarrjeve në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera etj. Yildirim International Mining Investments B.V. zotërohet 100% nga Yildirim International

Investments Holding B.V. dhe është pjesë e Grupit Yildirim, i cili operon në një numër të madh industrish si: metalurgji dhe miniera, qymyre dhe coke, energji, plehra kimike etj.

Grupi Yildirim është aktualisht aktiv në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij: Yildirim Albania Mining Investments SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti blerjen, mbajtjen dhe transferimin e pjesëmarrjeve në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera, financimi i këtyre shoqërive dhe ndërmarrjeve etj. Yildirim Albania Mining Investments SHPK zotëron 100% Albchrome Holding SHPK dhe Albanian Energy Supplier 2 SHPK.

*Albchrome Holding SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: ushtrim i të drejtave të administrimit dhe shfrytëzimit, rehabilitimit, modernizimit, financimit të minierave, impianteve dhe uzinave/fabrikave etj. Albchrome Holding SHPK zotëron plotësisht: Albchrome SHPK, prodhuesi më i madh i kromit dhe ferrokromit në Shqipëri, dhe Vllahen Mining SHPK.

*Albanian Energy Supplier 2 SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, ndërtimin, zhvillimin dhe menaxhimin e impianteve, sistemeve, të prodhimit, shpërndarjes, etj.

**Pala shitëse:** NKL Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar. NKL Limited është një shoqëri holding e cila nuk kryen aktivitetet tregtar, por ushtron kontrollin e vetëm dhe të drejtpërdrejtë mbi targetin Newco Ferronikeli Complex L.L.C. dhe kontrollin indirekt mbi filialin në Shqipëri, Newco Ferronikeli Complex SHPK.

NKL Limited zotërohet në pjesën më të madhe të saj nga Balfin-Balkan Finance Investment Group SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të veprimtarisë: investimi në instrumente financiare; investime në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme); ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të tretë. Pjesa tjetër e aksioneve të NKL Limited zotërohet nga aksionarë të tjerë.

**Target:** Newco Ferronikeli Complex L.L.C. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, e cila kryen veprimtari në sektorin minerar, kryesisht në nxjerrjen, prodhimin dhe tregtimin e produkteve minerale jo-metalike, nxjerrjen e torfës, prodhimin e hekurit dhe çelikut bazik etj. Newco Ferronikeli Complex L.L.C. kontrollon interesin në aksionet e filialit të saj, Newco Ferronikeli Complex SHPK, në Shqipëri.

Newco Ferronikeli Complex SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila fokusohet në shfrytëzimin, prodhimin dhe furnizimin e ferronikelit nga territoret e licencuara. Newco Ferronikeli Complex SHPK është një shoqëri relativisht e re dhe aktiviteti i saj fokusohet vetëm tek investimi.

## II. Përqendrimi

Më datë 31 maj 2022, shoqëritë Yildirim Kosovo Mining Investments L.L.C. dhe NKL Limited kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerje aksionesh”, ku shitësi shet aksionet e shoqërisë target dhe filialit të zotëruar prej tij, dhe blerësi blen aksione me efekt që nga Data e Mbylljes së marrëveshjes.

Në përfundim të transaksionit, Yildirim International Mining Investments B.V. do të fitojë kontrollin direkt mbi shoqërinë Newco Ferronikeli Complex L.L.C. dhe kontroll indirekt mbi filialin e saj, shoqërinë Newco Ferronikeli Complex SHPK.

Transaksion plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## III. Analiza e Konkurrencës

Komisioni Evropian në praktikën e tij të vendimmarrjes i ka përcaktuar si tregje të veçanta produkti për ferronikelin dhe ferrokromin. Ferrokromi dhe ferronikeli nuk janë zëvendësues për sa i përket cilësive për konsumatorin, pasi ato janë produkte të ndryshme që u përkasin tregjeve të ndryshme të produkteve dhe të prodhuara nga lëndë të para të ndryshme.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimi me ferronikel, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Aktivitetet tregtare të shoqërive pjesëmarrëse në këtë transaksion nuk janë të lidhura me njëra tjetrën, pasi nuk ka mbivendosje horizontale midis aktiviteteve të NewCo Ferronikeli Complex SHPK si degë e target, dhe Albchrome SHPK si filial i blerësit Yildirim Group.

Referuar të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për vitin 2020, rezultoi se në tregun e prodhimit të hekur-nikelit janë pajisur me leje të shfrytëzimit të hekur-nikelit 28 subjekte nga të cilat 17 nuk janë aktive. Prodhimi nxjerrës i hekur-nikelit ka qenë 432,673 ton në total. Shoqëria NewCo Ferronikeli Complex SHPK nuk është pjese e shoqërive prodhuese, kjo shoqëri është ende në fazën e investimeve. Ndërkohë që në tregun e prodhimit të kromit, janë pajisur me leje të shfrytëzimit të kromit 261 subjekte nga të cilat 77 nuk janë aktive. Prodhimi nxjerrës i kromit ka qenë 626,627 ton në total nga të cilat shoqëria Albchrome SHPK ka realizuar një prodhim prej 100,817 ton duke mbajtur 16 % të tregut të përgjithshëm të prodhimit të tij. Në tregun e prodhimit të ferrokromit, operojnë vetëm tre shoqëri, prodhimi i përgjithshëm për vitin 2020 ka qenë 53,544 ton, nga të cilat 63.7% janë realizuar nga Albchrome SHPK.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të shoqërisë NewCo Ferronikel Complex L.L.C. dhe si rrjedhojë edhe e filialit tërësisht në zotërim të saj, shoqërisë NewCo Ferronikeli Complex SHPK nga shoqëria Yildirim Kosovo Mining Investment L.L.C..

Shoqëria Yildirim Kosovo Mining Investment L.L.C. është pjesë e Yildirim Group, e cila nëpërmjet shoqërive në zotërim të tij, operon në Shqipëri në tregun e prodhimit dhe furnizimit të ferrokromit. Shoqëria Target, NewCo Ferronikel Complex L.L.C., nuk operon në Shqipëri por ka në zotërim të saj shoqërinë NewCo Ferronikeli Complex SHPK, e cila ka si objekt aktiviteti shfrytëzimin, prodhimin dhe furnizimin me ferronikel nga territoret e licencuara. Kjo shoqëri nuk është ende operacionale, pasi aktiviteti i saj fokusohet vetëm tek investimet.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje në tregje horizontale ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Newco Ferronikeli Complex LLC dhe filialit të saj nga shoqëria Yildirim Kosovo Mining Investments L.L.C.



2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 898, Datë 15.07.2022

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VARGON D.O.O NGA SHOQËRIA PIPELIFE INTERNATIONAL GMBH”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vargon d.o.o nga shoqëria Pipelife International GmbH.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit, të shoqërisë Vargon d.o.o nga shoqëria Pipelife International GmbH.

## VËREN SE :

### IV. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vargon d.o.o nga shoqëria Pipelife International GmbH.

Referuar dokumentit të lidhur “Marrëveshje e blerjes së aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

**Blerësi:** Pipelife International GmbH, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit të Austrisë, me objekt aktiviteti: prodhim i plastikës si tuba dhe pajisje plastike, tuba për mbrojtjen e kabllave elektrike, prodhimi i plastikës, ndarësit e vajit, dhomat, Stormbox, tuba PVC, tuba PP, tuba PE, formimi me rrotullim, ekstrudimi dhe menaxhimi i ujërave të zeza.

Pipelife International GmbH i përket Grupit Wienerberger, i cili është furnizues global i materialeve të ndërtimit dhe zgjidhjeve të infrastrukturës, etj, e kontrolluar përfundimisht nga Wienerberger AG, një shoqëri mbajtëse (holding) e të gjithë grupit.

Pipelife International GmbH nuk ka degë apo filial të regjistruar në Shqipëri por realizon të ardhura nga furnitorë të pavarur.

**Shitësi 1:** Goran Brašnic , është shtetas kroat dhe themelues i shoqërisë Vargon d.o.o.

**Shitësi 2:** Nikica Brašnic , është shtetas kroat dhe themelues i shoqërisë Vargon d.o.o.

**Shitësi 3:** Josip Brašnic , është shtetas kroat dhe themelues i shoqërisë Vargon d.o.o.

**Target:** Vargon d.o.o, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit të Kroacisë dhe me objekt aktiviteti: procesimin e plastikës dhe të metaleve, etj. Ortakët e shoqërisë zotërojnë nga 33.33% të aksioneve të shoqërisë.

## V. Përqendrimi

Ndërmjet palëve, Pipelife International GmbH (Blerësi), Goran Brašnic (Shitësi 1), Nikica Brašnic (Shitësi 2) dhe Josip Brašnic (Shitësi 3) është lidhur “Marrëveshje e blerjes së aksioneve”, datë 07.06.2022<sup>1</sup> në lidhje me shitjen e 79,67% të aksioneve në shoqërinë Vargon d.o.o e cila konsiston në shitjen e aksioneve të *shitësi 1* që përfaqësojnë 13% të kapitalit aksionar të shoqërisë, *shitësi 2* që përfaqësojnë 33,33% të kapitalit aksionar të shoqërisë dhe *shitësi 3* që përfaqësojnë 33,33% të kapitalit aksionar të shoqërisë.

Referuar kësaj marrëveshje dhe në varësi të kushteve të saj, shitësit e mësipërm pranojnë të shesin dhe ti transferojnë aksionet tek blerësi, së bashku me të gjitha të drejtat që i përkasin dhe pa ndonjë barrë për blerësin dhe blerësi pranon të blejë dhe të marrë aksionet nga shitësit në çdo rast mbyllje. Shitësit janë aksionarët e vetëm të shoqërisë Vargon d.o.o.

Pas transaksionit, blerësi do të zotërojë 79.67% të shoqërisë target dhe pjesa tjetër, 20.33% do të zotërohet nga z Goran Brašnic.

Transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## VI. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i tubave dhe sistemeve të tubacioneve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë Vargon d.o.o. nga shoqëria Pipelife International GmbH.

Pipelife International GmbH është pjesë e Wienerberger Group, një furnizues global i materialeve të ndërtimit dhe zgjidhjeve të infrastrukturës, me fokus në materialet e ndërtimit të mureve, materialet e çatisë dhe sistemet e tubacioneve, i cili nuk ka prezence ligjore në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet disa aktiviteteve të kufizuara në projekte infrastrukture (ujë dhe kanalizime).

Vargon d.o.o. është një prodhues rajonal i tubave dhe pjesëve plastike për aplikime në shtëpi dhe në infrastrukturë. Vargon nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri por realizon një xhiro të papërfillshme

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

---

<sup>1</sup> Sipas shkresës nr. 435/2 prot.AK datë 08.07.2022 “Deklaratë mbi xhiron e palëve në transaksionin Pipelife International GmbH/ Vargon si dhe një sqarim në lidhje me datën e marrëveshjes së transaksionit”

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 899, Datë 15.07.2022

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SIKKIM HYDRO POWER VENTURES LTD. NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS..

## VËREN SE :

### VII. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Referuar dokumentacionit të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe Draft Marrëveshjes për blerje, palët janë:

**Pala blerëse:** Statkraft IH Holdings AS, është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme. Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit), në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria

Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike..etj.

*Devoll Hydropower SHA*, shoqëri aksionare me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisë prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

**Shoqëria Target:** Sikkim Hydro Power Ventures Ltd., është një shoqëri e regjistruar sipas Ligjit të Shoqërive 1956 me seli në Mumbai, Maharashtra, Indi. Target është një SPV e krijuar nga Gammon Group në vitin 2005, me qëllim ndërtimin e një projekti të prodhimit të energjisë hidrike në lumin Rimbi Khola në Sikkim (Veri-Lindje e Indisë). Fokusi i target është ndërtimi dhe operimi i projekteve hidrike dhe furnizimi me energji i konsumatorëve.

Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

**Pala shitëse:** AJR Infra and Tolling Ltd, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë. AJR Infra And Tolling Limited ("AJRITL") është një shoqëri e zhvillimit të projekteve infrastrukturore e promovuar nga Gammon India Limited, për të marrë pjesë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës mbi bazën e partneritetit publik privat ("PPP").

## VIII. Përqendrimi

Referuar Draft- Marrëveshjes për blerje aksionesh rezulton se, shitësi zotëron pronësinë ligjore dhe përfituese të 6,27,35,942 aksione të kapitalit që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë target pa asnjë barrë.

Duke u mbështetur në garancitë, marrëveshjet edhe angazhimet e shitësit, shoqëria AJR Infra and Tolling Ltd dhe targetit, shoqëria Sikkim Hydro Power Ventures Ltd., blerësi ka rënë dakort të blejë dhe shitësi ka rënë dakord të shesë dhe ti dorëzojë blerësit aksionet që tregtohen pa asnjë barrë dhe së bashku me të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat mbi to pas pagesës së shumës së shitjes në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Draft Marrëveshje.

Detyrimi i blerësit për të blerë aksionet që tregtohen dhe për ti paguar shitësit shumën e shitjes në datën e mbylljes do të kushtëzohet me përmbushjen nga shitësi, në një formë dhe mënyrë të pranueshme për blerësin, ose me heqjen dorë me shkrim nga blerësi, sipas gjykimit të tij të të gjitha kushteve të përcaktuara (Kushtet Paraprake).

Menjëherë pas përmbushjes së Kushteve Paraprake, shitësi do të njoftojë blerësin për përmbushjen e të gjitha Kushteve Paraprake duke dorëzuar një certifikatë në formatin siç përcaktohet në shtojcën përkatëse.

Pas lëshimit të certifikatës së plotësimit të Kushteve Paraprake nga blerësi, palët do të vazhdojnë mbylljen e Marrëveshjes.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aksioneve në shoqërinë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS, e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes dhe plotësimin e Kushteve Paraprake.

Në zbatim të nenit 60, pika 1 të ligjit nr. 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar pajisjen me një autorizim për realizim të përkohshëm të përqendrimit, deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit, nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS, duke plotësuar kriteret e nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003.

Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, shoqëria mëmë e Grupit Statkraft. Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

Sikkim Hydro Power Ventures Ltd., është një shoqëri e regjistruar në Indi. Target është një SPV e krijuar nga Gammon Group në vitin 2005, me qëllim ndërtimin e një projekti të prodhimit të energjisë hidrike në lumin Rimbi Khola në Sikkim (Veri-Lindje e Indisë).

Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri. Fokusi i tij është ndërtimi dhe operimi i projekteve hidrike dhe furnizimi me energji i konsumatorëve në Indi.

Bazuar në dokumentacionin e depozituar, përqendrimi i propozuar nuk pritet të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar duket se nuk do të sjellë ndryshim dhe duket se nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për sa më sipër, bazuar nënen 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 900, Datë 15.07.2022**

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME KONISPOL SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15 .07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për miratimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA.

**VËREN SE:**

1. ERRU me nëpërmjet shkresën nr. 294 prot., datë 01.07.2021, informon Autoritetin e Konkurrencës mbi Projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 536 prot., datë 30.12.2021, shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës, se ka përfunduar procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të aplikimit të ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë, të cilat konsistojnë në ligjërimin e nivelit të tarifave të këtij shërbimi për të tre kategoritë e klientëve.
2. Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ERRU nëpërmjet strukturës së saj vendimmarrëse, Komisionit Kombëtar Rregullator, miraton çmimet dhe tarifat e shites së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik.
3. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU duhet të mbrojë konsumatorët nga çmimet monopol, të inkurajojë efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të paktët, të pasqyrojnë ndryshimet në kosto



dhe në aspekte të tjera midis kategorive të klientëve dhe llojeve të shërbimit dhe të aplikojë politika rregullatore të subvencionimit ndërmjet këtyre kategorive.

4. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin tregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU ka miratuar “Metodologjinë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”. Bazuar në këtë metodologji shqyrtimi i aplikimit për ndryshim tarife fillon me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe analizën e treguesve të performancës. Rritja e tarifave duhet të bëhet gradualisht në vitet në vazhdim, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet në përmirësimin e performancës së shërbimeve. Tarifat e reja duhet të jenë të orientuara drejt kostove të justifikuara, rritjes së efikasitetit, vendosjen e objektivave përkatës për përmirësimin e tyre, si edhe verifikimin e kriterit të përballeshmërisë së pagesës së faturës së shërbimeve nga konsumatorët. I gjithë procesi duhet të shoqërohet me transparencë ndaj publikut i cili duhet të informohet në një seancë dëgjimore paraprake mbi tarifën e reja që shoqëria synon të aplikojë në propozimin e saj.
5. Ndërmarrja Ujësjetillës Kanalizime Konispol SHA është licencuar me vendimin e KKRR nr. 39, datë 01.06.2018, i ndryshuar, për të kryer shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm me zonë shërbimi Bashkinë Konispol.
6. Ndërmarrja Ujësjetillës Kanalizime Konispol SHA aplikon për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë për herë të parë pranë ERRU pas licencimit dhe kërkon të ligjërojë tarifën që aktualisht aplikon, si dhe të krijojë gradualisht qendrueshmërinë finansiare për shoqërinë pasi të ardhurat aktuale nga tarifën arrijnë të mbulojnë vetëm 59% të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes.
7. Informacioni mbi aplikimin si dhe vendimi i KKRR nr. 536, datë 30.12.2021 “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjetillës Kanalizime Konispol”, janë bërë transparente në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
8. Ndërmarrja Ujësjetillës Kanalizime Konispol SHA ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbim furnizimi me ujë në nivelin 94.9% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, uji pa të ardhura në nivelin 35.02%, norma korrente e arkëtimit në 98.5%, operon me 10.9 staf/1000 lidhje dhe me të ardhurat e gjeneruara mbulon 59 % kostot e O&M.
9. Niveli tarifor i propozuar nga ERRU, është në të njëjtat nivele me ato që ndërmarrja Ujësjetillës Kanalizime Konispol SHA propozon, duke synuar dhe përmbushur kriteret e mëposhtme:
  - Aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe rregullimin e tyre në të gjithë zonën.
  - Përmirësimin e Treguesit UPA në nivelet 30.3 % staf/1000 lidhje UK, nëpërmjet vlerësimit në mënyrë të saktë të ujit të prodhuar dhe të faturuar bazuar në rritjen e numrit të lidhjeve, konsumit mesatar mujor dhe parashikimit të veprimtarisë së ndërmarrjes për reduktimin e humbjeve. Për përmirësimin e mëtejshëm të treguesit, ndërmarrja duhet të ndërmarrë aksionin për eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës dhe riparimin në kohë të defekteve në rrjet.

- Mbulimin e kostove të operimit & mirëmbajtjes deri 56.4% me të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti e të tjera, të rillogaritura bazar në rritjen e numrit të lidhjeve dhe konsumit mesatar mujor  $12\text{m}^3$ , dhe me kostot e rivlerësuara për shkak të rritjes së çmimit/njësi të energjisë elektrike, duke marrë për bazë çmimin mesatar/njësi të vitit 2022.
  - Përmbushjen e kriterit të përballshmërisë për faturën mujore të konsumatorit familjar me matës dhe pa matës.
10. ERRU e gjykon të argumentuar nivelin tarifor të propozuar nga ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA. Për shkak edhe të ndjeshmërisë së konsumatorit ndaj rritjes së çmimeve këtë periudhë, në këtë aplikim nuk u konsiderua një variant me tarifa të unifikuara për të gjithë zonën apo aplikimi i një tarife fikse për disponibilitetin e shërbimit.
11. Për vlerësimin e kostove së arritshme të një ndërmarrje UK, rregullatori përdor si bazë kostot sipas shërbimeve, duke siguruar një nivel të arsyeshëm rritje tarifash në raport me shërbimin e ofruar si dhe të cilësisë së shërbimit. Kjo ka sjellë vendosjen e tarifave duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
12. ERRU në analizën ekonomiko-financiare të saj, ka analizuar drejt dhe ka marrë në konsideratë vetëm kostot e justifikuara të paraqitura nga ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA, të cilat përcaktojnë nevojat për të ardhura të ndërmarrjes si faktori bazë përcaktues në procesin e miratimit të tarifave si dhe ka përcaktuar objektivat e performancës tekniko-financiare të shoqërisë.
13. Për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA, duhet të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos së shërbimeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit, që tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Konispol SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve, të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit dhe të jenë transparente në faqen e ERRU-së.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 901, Datë 29.07.2022

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË VISHNUPRIYA FARMS PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Referuar “Marrëveshje për blerje aksionesh” (draft), 02 qershor 2022, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse:** Statkraft IH Holdings AS, është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme. Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit), në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike..etj.

*Devoll Hydropower SHA*, shoqëri aksionare me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

**Shoqëria Target:** Vishnupriya Farms Private Limited, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, shoqëri jo-qeveritare me aksione të kufizuara. Target është një shoqëri që tradicionalisht ka qenë aktive në rritjen dhe shitjen e produkteve bujqësore, por së fundmi ndryshoi modelin e biznesit duke përdorur tokat për prodhim të energjisë solare. Shoqëria është e zotëruar nga Silvergates Holdings and Investments Private Limited (99.9%) dhe një ortak i nominuar (0.1%).

Shoqëria Vishnupriya Farms Private Limited, e mbështetur nga Z. Murali Barathwaj dhe familja e tij, është një shoqëri holding dhe vepron si shoqëri investimi në shoqëri grupi.

### **Pala shitëse:**

**Shitësi 1:** Silvergates Holdings & Investment Private Limited, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, shoqëri jo-qeveritare me aksione të kufizuara.

**Shitësi 2:** Z. Prashanth Krishnan, rezident dhe qytetar i Indisë.

## **II. Përqendrimi**

Referuar dokumentacionit të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe Marrëveshje për blerje aksionesh (draft), 02 qershor 2022, rezulton se: Blerësi është i angazhuar në biznesin e ngritjes të termocentraleve duke përfshirë energjinë diellore, të erës dhe hidro në Indi dhe dëshiron të zhvillojë një projekt të energjisë diellore në Tamil Nadu.

Shitësit zotërojnë kolektivisht 100% të të gjithë kapitalit aksionar të emetuar, të nënshkruar dhe të paguar shoqërisë, që nga data e ekzekutimit, të lirë dhe të pastër nga çdo dhe të gjitha barrët. Kuotat do të shiten dhe transferohen tek blerësi së bashku me të drejtat, titullin, interesat, privilegjet të shitësit, të lira nga çdo barrë.

Detyrimi i blerësit për të blerë aksionet e shitjes do të jetë subjekt dhe i kushtëzuar me përmbushjen e secilit prej kushteve paraprake sipas kërkesës së blerësit. Mbyllja e këtij transaksioni do të bëhet pas plotësimit të veprimeve të përcaktuara në Nenin 6 “Mbyllja”, të marrëveshjes. Nëse palët nuk do të arrijnë mbylljen në ose përpara “Long Stop Date” atëherë kjo marrëveshje do të zgjidhet automatikisht në përputhje me nenin 11 “zgjdhja”, pa përgjegjësi për asnjërën palë.

Pas përfundimit të shitjes dhe blerjes të letrave me vlerë të shitjes në datën e mbylljes, Blerësi do të mbajë 100% të kapitalit aksionar, plotësisht të emetuar të nënshkruar dhe të paguar, të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited. Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aksioneve në shoqërinë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS, e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes dhe plotësimit të Kushteve Paraprake.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët, duke argumentuar<sup>2</sup> se Statkraft Group është në një periudhë investimi në tregun indian, duke synuar projekte relativisht të vogla, të cilat janë të pajisura më lejet të nevojshme, por që kanë mbetur në vend për mungesë financimesh.

Për shkak se, projektet kanë kapacitet instalimi të ulët në shumë raste, përfshirë projektin në fjalë, nuk ka

<sup>2</sup> Shkresa nr. 492/2 prot.AK datë 28.07.2022 “Argumente në vijim të shkresës nr. 492 datë 20.07.2022”

nevojë për miratim nga Autoriteti i Konkurrencës në Indi dhe as në ndonjë vend tjetër.

Rrjedhimisht, shitësi niset me prezumimin se transaksioni mbyllet me firmosjen e marrëveshjes dhe pagesën e menjëhershme të çmimit të blerjes. Në rastin e Statkraft, duke qenë një shoqëri globale dhe për shkak të nevojës për miratim nga Autoriteti Shqiptar, Statkraft është e detyruar të vendosë kushte shtesë ndaj shitësit, për të kërkuar kohën e nevojshme nga firmosja e marrëveshjes dhe marrja e miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës, në mënyrë që pas plotësimit të këtij kushti, të bëjnë edhe pagesën e çmimit. Blerësit e tjerë potencial në Indi, për të njëjtin projekt nuk e kanë një kusht të tillë dhe tregu indian ka shumë blerës potencial për të blerë projekte të tilla.

Kjo do të thotë se për shkak të shtyrjes në kohë të finalizimit të marrëveshjes dhe arkëtimit nga blerësi të çmimit, Statkraft vihet në disavantazh kundrejt blerësve të tjerë. Në një projekt në muajin qershor, blerësi u tërhoq nga negociimi me Statkraft pikërisht për këtë arsye.

Afatet kohore që kërkohen nga Autoriteti i Konkurrencës për procedurën e kontrollit të një përqendrimi, e vendosin Statkraft në disavantazhin e një investimi të shpejtë, ndërkohë që ka të gjitha fondet në dispozicion për të paguar çmimin e blerjes, duke përfituar kështu nga fakti që ka likuiditete të lira kundrejt blerësve të tjerë, duke dëmtuar planet ekonomike dhe imazhin e kompanisë.

Referuar draft marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Shoqëria blerëse, Statkraft IH Holdings AS, është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, shoqëria mëmë e Grupit Statkraft, e cila është prezente në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

Shoqëria target, Vishnupriya Farms Private Limited, është një shoqëri e regjistruar në Indi, aktive në prodhim të energjisë solare, e cila nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri. Aktiviteti i tij fokusohet në Indi. Blerja e tij është thelbësore në ngritjen e një projekti të dytë solar në Tamil Nadu.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për sa më sipër, bazuar nën 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.

3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 902, Datë 29.07.2022**

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME KUKËS SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim Kraja	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për miratimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA.

**VËREN SE:**

1. ERRU nëpërmjet shkresës nr. 328 prot., datë 14.07.2022, informon Autoritetin e Konkurrencës se me Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 537 prot., datë 30.12.2021, shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës, se ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e nivelit tarifor të ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë miratimin e nivelit tarifor të ndryshuar të ofrimit të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotur si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ERRU nëpërmjet strukturës së saj vendimmarrëse, Komisionit Kombëtar Rregullator, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifatat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifatat për ujërat e përdorura dhe tarifatat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik edhe në rastet kur sistemet e ujësjiellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësive të qeverisjes vendore.
3. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU duhet të mbrojë konsumatorët nga çmimet monopol, të inkurajojë efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë

sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të paktët, të pasqyrojnë ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera midis kategorive të klientëve dhe llojeve të shërbimit dhe të aplikojë politika rregullatore të subvencionimit ndërmjet këtyre kategorive.

4. Bazuar në parashikimet e nenit 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ERRU përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të shitjes me shumicë dhe pakicë, të ujit për konsum publik, tarifave për ujërat e përdorura dhe trajtimit të tyre, ndërkohë që procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licensuari, dhënien e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga ERRU.
5. Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA është licencuar me Vendimin e KKRR nr. 122 datë 20.10.2020, për të kryer shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimin e ujërave të ndotur për katër vite në Bashkinë Kukës.
6. Bazuar në VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA aplikon për vendosjen e tarifës fikse dhe për rritje të tarifave variabël për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për të tre kategorive të konsumatorëve, për shkak të nevojës për të ardhura dhe për krijimin gradual të qëndrueshmërisë financiare. Tarifave që UK Kukës aplikon nuk janë të miratuara nga ERRU, pasi u ka mbaruar afati.
7. Informacioni mbi aplikimin si dhe vendimi i KKRR nr. 537, datë 30.12.2021 “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kukës”, janë bërë transparente në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
8. Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbim furnizimi me ujë në nivelin 60.4% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, uji pa të ardhura në nivelin 56.5%, norma korrente e arkëtimit në 47%, operon me 6.62 staf/1000 lidhje dhe me të ardhurat e gjeneruara mbulon 100.3% kostot e O&M.
9. Niveli tarifor i propozuar nga ERRU, është në të njëjtat nivele me ato që ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Kukës SHA propozon, duke synuar dhe përmbushur kriteret e mëposhtme:
  - Aplikimin e ndryshimit progresiv gradual të nivelit tarifor të tarifave të miratuara nga ERRU dhe rregullimin e tyre në të gjithë zonën.
  - Përmirësimin e Treguesit UPA në nivelet 48.9%, nëpërmjet vlerësimit në mënyrë të saktë të ujit të prodhuar dhe të faturuar bazuar në rritjen e numrit të lidhjeve, konsumit mesatar mujor dhe parashikimit të veprimtarisë së ndërmarrjes për reduktimin e humbjeve. Për përmirësimin e mëtejshëm të treguesit, ndërmarrja duhet të ndërmarrë aksionin për eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës dhe riparimin në kohë të defekteve në rrjet.



- Mbulimin e kostove të operimit & mirëmbajtjes deri 120.9% me të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti e të tjera, të rillogaritura bazuar në rritjen e numrit të lidhjeve dhe konsumit mesatar mujor 12m<sup>3</sup>, dhe me kostot e personelit të rivlerësuara.
- Përbushjen e kriterit të përballeshmërisë për faturën mujore të konsumatorit familjar me matës dhe pa matës.

10. ERRU në këtë aplikim ka propozuar tarifa në rritje graduale, më të vogël se propozimi i tarifave të bëra nga ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Kukës SHA dhe e përqendron aplikimin në saktësimin e të dhënave të regjistruara dhe ta raportuara dhe vendos detyra me synim rregullimin e variablave që llogarisin treguesit kryesorë të performancës.

11. Propozimi gradual i ERRU, për tarifa merr në konsideratë edhe nivelin shumë të ulët të normës korrente të arkëtimit, e cila identifikohet si treguesi më problematik për shkak se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Kukës SHA nuk arrin të grumbullojë të ardhurat e saj dhe për këtë arsye duhet të jetë fokus kryesor në politikat e menaxhimit të ndërmarrjes.

12. Për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Kukës SHA, duhet të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos së shërbimeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit, që tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Kukës SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve, të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit dhe të jenë transparente në faqen e ERRU-së.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 903, Datë 29.07.2022

### “PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR MIRATIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN UJËSJELLËS KANALIZIME BULQIZË SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim Kraja	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për miratimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA.

#### VËREN SE:

1. ERRU nëpërmjet shkresës nr. 330 prot., datë 14.07.2022, informon Autoritetin e Konkurrencës se me Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 538 prot., datë 30.12.2021, shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës, se ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e nivelit tarifor të ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë miratimin e nivelit tarifor të ndryshuar të ofrimit të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotur dhe tarifatat fikse në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ERRU nëpërmjet strukturës së saj vendimmarrëse, Komisionit Kombëtar Rregullator, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifatat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifatat për ujërat e përdorura dhe tarifatat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruara nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik edhe në rastet kur sistemet e ujësjiellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësive të qeverisjes vendore.
3. Bazuar në parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU duhet të mbrojë konsumatorët nga çmimet monopol, të inkurajojë efikasitetin ekonomik brenda sektorit, duke dhënë

sinjale të sakta të çmimeve në lidhje me ofertën e tepërt apo të paktët, të pasqyrojnë ndryshimet në kosto dhe në aspekte të tjera midis kategorive të klientëve dhe llojeve të shërbimit dhe të aplikojë politika rregullatore të subvencionimit ndërmjet këtyre kategorive.

4. Bazuar në parashikimet e nenit 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ERRU përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të shitjes me shumicë dhe pakicë, të ujit për konsum publik, tarifat për ujërat e përdorura dhe trajtimit të tyre, ndërkohë që procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licensuari, dhënien e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga ERRU.
5. Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA është licencuar me Vendimin e KKRR nr. 91 datë 28.07.2020, për të kryer shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimin e ujërave të ndotur për Bashkinë Bulqizë.
6. Bazuar në VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA aplikon për miratimin e një niveli të ri të unifikuar për tarifën në të gjithë zonën e shërbimit për shërbimin FU për klientët familjarë me matës dhe rritje të nivelit të tarifës aforfe për klientët familjarë pa matës edhe për kategoritë e klientëve publikë dhe privatë aplikohet për një rritje të nivelit tarifor, duke marrë në konsideratë nënkategorinë e klientëve publike Spitale, ku kërkesa për rritje të nivelit tarifor është më e ulët. Ndërsa për shërbimin KUN, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA aplikon tarifë pranë ERRU pas një periudhe dhjetë vjeçare të miratimit të tarifave sipas Vendimit nr. 25, datë 17.10.2012. Aktualisht Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA pas riorganizimit të bashkisë kërkon miratimin e tarifave në një nivel të ri të arsyeshëm dhe të përballueshëm.
7. Informacioni mbi aplikimin si dhe vendimi i KKRR nr. 538, datë 30.12.2021 “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë”, janë bërë transparente në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
8. Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë SHA ofron shërbimin e furnizimit me ujë me treguesit e performancës, përkatësisht: mbulimi me shërbim furnizimi me ujë në nivelin 46.5% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për 20.9% të popullsisë, uji pa të ardhura në nivelin 49.4%, norma korrente e arkëtimit në 70.2%, operon me 9.1 staf/1000 lidhje dhe me të ardhurat e gjeneruara mbulon 91.4% kostot e O&M.
9. Niveli tarifor i propozuar nga ERRU, është pothuajse në të njëjtat nivele me ato që shoqëria propozon, duke synuar dhe përmbushur kriteret e mëposhtme:
  - Unifikimin e tarifave volumetrike për FU;
  - Unifikimin e tarifës fikse për të gjithë klientët;
  - Tarifat volumetrike për shërbimin e KUN;

- Mbulimin 94% të kostos totale të nevojshme për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë;
  - Mbulimin e kostove totale për shërbimet e ofruara UK në nivelin 100% për vitin 2022 me të ardhurat e faturuara UK;
  - Përmbushjen e kriterit të përballshmërisë për faturën mujore të konsumatorit familjar me matës dhe pa matës.
10. Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA është një ndërmarrje e riorganizuar, që aplikon për herë të parë pas riorganizimit dhe sipas kësaj metodologjie bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e operim & mirëmbajtjes dhe objektivi i saj është fillimisht mbulimi i kostove O&M, duke synuar mbulimin e kostove të amortizimit për vitin 2022.
11. ERRU e gjykon të argumentuar nivelin tarifor për të dy shërbimet të propozuar nga ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA.
12. ERRU në këtë aplikim ka propozuar tarifa në rritje graduale, pas dhjetë vjetësh të miratimit të tyre se propozimi i tarifave të bëra nga ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA dhe e përqendron aplikimin në saktësimin e të dhënave të regjistruara dhe të raportuara dhe vendos detyra me synim rregullimin e variablave që llogarisin treguesit kryesorë të performancës.
13. Propozimi gradual i ERRU, për tarifa merr në konsideratë edhe nivelin shumë të ulët të normës korrente të arkëtimit, e cila identifikohet si treguesi më problematik për shkak se ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA nuk arrin të grumbullojë të ardhurat e saj dhe për këtë arsye duhet të jetë fokus kryesor në politikat e menaxhimit të ndërmarrjes.
14. ERRU në analizën ekonomiko-financiare të saj, ka analizuar drejt dhe ka marrë në konsideratë vetëm kostot e justifikuara të paraqitura nga ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA, të cilat përcaktojnë nevojat për të ardhura të ndërmarrjes si faktori bazë përcaktues në procesin e miratimit të tarifave si dhe ka përcaktuar objektivat e performancës tekniko-financiare të shoqërisë.
15. Për përmirësimin e performancës financiare dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA, duhet të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos së shërbimeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) e (f), nenin 69 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

- I. T'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit, që tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetës Kanalizime Bulqizë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve, të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit dhe të jenë transparente në faqen e ERRU-së.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 904, Datë 29.07.2022**

**“PËR VAZHDIMIN E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MIDIS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR KARTONIN JESHIL”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana IKONOMI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 5, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003), ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil,

**VËREN SE :**

**I. Procedura e ndjekur:**

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, ka vendosur:
  - a. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
  - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
    - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
    - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e

- tregton dhe bar kodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
- c. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
  - d. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”, ka vendosur:
- a. Monitorimin në vazhdimësi të tregut të sigurimeve për shitjen dhe administrimit të kartonit jeshil, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020.
  - b. Detyrimin e AMF për të parashtruar pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo rast që pengon, kufizon, apo shtrembëron konkurrencën, në lidhje me tregun e shitjes së policës - kartoni jeshil.
3. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 689, datë 24.04.2020 “Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, ka vendosur:
- a. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil;
  - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
    - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
    - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregton dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
  - c. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
  - d. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
4. AK ka bashkëpunuar me BSHS dhe ndërmarrjet e sigurimit, duke kërkuar informacion për zbatimin e vendimit nr. 689, datë 24.04.2020 dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor, për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes.
5. Referuar “Raportit të monitorimit mbi zbatimin e vendimit nr. 689, datë 24.04.2020 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”, nr. 40/10 prot., datë 24.04.2022, është konkluduar se shoqëritë e sigurimit: kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 689, datë 24.04.2021 “Për

vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, në të gjitha pikat e vendosura pa kufizuar lirinë tregtare dhe konsumatore, duke mos kufizuar të drejtën e konsumatorëve dhe klientëve për të zgjedhur produktin dhe duke ofruar shitjen e këtij produkti në të gjitha pikat e shitjes të shoqërisë në degë, ndërmjetës dhe pika të kalimit kufitar ku shoqëritë kanë pika shitje. Tregtojnë produktin karton jeshil nëpërmjet pikave të shitjes dhe ndërmjetësve të licensuar nga AMF në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit përmban logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës. Çmimet e shitjes janë ato të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

6. Byroja Shqiptare e Sigurimit, duke qenë në përfundim të afatit të parashikuar në VKK nr. 689, datë 24.04.2020, me shkresën nr. 236 prot., datë 30.03.2022 “Mbi shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes”, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka kërkuar zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2025.

## **II. Palët në marrëveshje**

7. Palët në marrëveshje janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e kartonit jeshil të sigurimit të mjeteve motorike.

## **III. Përshkrimi i marrëveshjes**

8. Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike të kartonit jeshil, lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil me qëllim kryesor përmirësimin dhe rritjen e garancisë.
9. Sipas BSHS, marrëveshja lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve, të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me:
  - i. Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve;
  - ii. Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta për eliminimin e policave false dhe vendosjen e sistemit të kodit unikal-bar kod dhe njoftimin në kohë reale në sistemin e informacionit të AMF-së të çdo police të kartonit jeshil;
  - iii. Shlyerja e dëmeve (parashikohet rritja e pagesës së dëmeve dhe marrja përsipër nga shoqëritë e sigurimit të pagesës së dëmeve duke shmangur policat false, të cilat ekspozonin qytetarët që kanë marrë këtë produkt para përgjegjësive penale dhe financiare për dëmet e shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me mjetet e tyre motorike);
  - iv. Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë (sistemi i kodit unikal dhe verifikimi nëpërmjet pajisjeve të sigurisë në pikat e kalimit kufitar për verifikimin e bar-kodit unikal që vlerëson nëse polica e sigurimit të kartonit jeshil është e vlefshme dhe është sipas klasës së mjetit motorik).



10. Qëllimi i marrëveshjes është:

- i. Shitja e policave të kartonit jeshil nëpërmjet një numri të autorizuar operatorësh në pikat e kalimit kufitar dhe degët qendrore të shoqërive të sigurimit;
- ii. Procesi i shitjes të realizohet me anë të shoqërisë së brokerimit të autorizuar nga Byroja, e cila ka stafin teknik, sistemin e shitjes online në kohë reale që mundëson gjenerimin e Kodit Unik (Nr. serial – bar kod) dhe broker fizik të licencuar.
- iii. Të rrisë garancinë dhe sigurinë e këtij shërbimi në përputhje me standardet COB (Këshillit të Byrove), shmangien e kolapsit për përjashtimin e BSHS nga Sistemi Ndërkombëtar i Kartonit Jeshil;
- iv. Rritjen e garancisë së drejtuesve të mjeteve, të cilët përdorin automjete përtej kufirit të RSH, të cilët duhet të jenë të siguruar kur hyjnë në vende ku një sigurim i tillë është i detyrueshëm;
- v. BSHS të hiqet nga statusi i monitorimit nën të cilin e ka vënë COB, (i cili është me afat jo më pak se pesë vjet) dhe të mos lejojë përjashtimin e tij nga COB.
- vi. Forcimin e sigurisë financiare të ofertuesve të këtij sigurimi.

11. Sipas BSHS kjo marrëveshje ka efekte vetëm për produktin karton jeshil, i cili zë një pjesë të vogël të totalit të tregut të sigurimeve dhe i shtrin efektet në zonën gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja nuk kufizon lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij.

#### **IV. Tregu Përkatës**

##### **a. Tregu përkatës i produktit**

12. Kartoni Jeshil mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, ndaj dëmeve që u shkakton palëve të treta, në përputhje me parashikimin e Ligjit të një prej shteteve anëtare të Këshillit të Byrove, ku ka ndodhur rasti në sigurim. “Kartoni jeshil” është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, e cila rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil. Drejtuesi i mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet, me regjistrim të huaj, duhet të jetë i pajisur me: a) karton jeshil, të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe, për mjetet me targë regjistrimi të shtetit tjetër, nënshkrues të kësaj marrëveshjeje.

13. Kjo policë lëshohet në territorin e Shqipërisë vetëm për automjetet me targa shqiptare dhe vepron jashtë territorit të Shqipërisë. Për njohjen e vlefshmërisë së dokumenteve ndërkombëtare të sigurimit, byroja njofton paraprakisht, autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar janë të detyruara të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave, të parashikuara në ligj.

##### **b. Tregu përkatës gjeografik**

14. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Meqenëse produkti (shërbimi) ofrohet në të gjitha pikat e licencuara për tregtimin e kartonit jeshil atëherë si treg gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

## V. Analiza e konkurrencës

15. Tregjet e sigurimeve në përgjithësi dhe kartonit jeshil në veçanti janë të rregulluar dhe të mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit organik nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.
16. Ndër 3 konkurrentët kryesorë në treg janë: për vitin 2020 ndërmarrjet: Sigal me 24.99%, Eurosig me 23.85%, dhe Sigma me 12.49%; për vitin 2021 ndërmarrjet: Sigal me 24.97%, Eurosig me 23.93%, dhe Sigma me 12.50%; për periudhën janar- shkurt 2022 ndërmarrjet: Sigal me 24.66%, Eurosig me 23.93%, dhe Sigma me 12.22%.
17. Sipas renditjes në vite ndërmarrja Sigal radhitet e para (2020 - 2021 dhe janar - shkurt 2022) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë gjithë periudhës, ndërmarrja Eurosig renditet e dyta (2020 - 2021 dhe janar - shkurt 2022) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut, ndërmarrja Sigma gjithashtu me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut.
18. Nga vlerësimi i indeksit HHI për periudhën 2020-2021 dhe janar - shkurt 2022, ndërmarrjet kanë ruajtur pothuajse të njëjtën shkallë përqendrimi për vitin 2020 dhe 2021 duke e ulur pastaj në periudhën dy mujore të 2022 (HHI në vitin 2020 është 1743.72, në vitin 2021 është 1743.92 dhe janar - shkurt 2022 është 1722.37) duke qenë një treg me përqendrim të moderuar, por në nivelin e poshtëm të këtij të fundit. Kartoni jeshil për vitin 2021, zë një peshë specifike me 10.01% në totalin e tregut të sigurimeve të mjeteve motorike.

## VI. Arsyet e përjashtimit nga ndalimi

19. Sektori i sigurimeve është një nga sektorët e tregut financiar ku marrëveshjet mes operatorëve për qëllime të mbulimit të riskut të përbashkët dhe standardizimit të produkteve mund të përfitojnë nga përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të nenit 5 dhe neneve 48-52 të ligjit nr. 9121/2003 dhe akteve nënligjore që përfshijnë udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve” dhe “Formularin për njoftimin e marrëveshjeve”.
20. Duke qenë në përfundim të afatit të parashikuar në VKK nr. 689, datë 24.04.2020, BSHS ka kërkuar në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2025.
21. Sipas BSHS gjatë kësaj periudhe, shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS, kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 689, datë 24.04.2022.

22. BSHS u shpreh se, VKK nr. 689/2020 ka patur efektet e tij pozitive mbi tregun në përgjithësi dhe konsumatorët në veçanti, duke përmendur faktin se:
- Gjatë kësaj periudhë nuk ka patur rritje të çmimit të kartonit jeshil nga siguruesit, po ashtu as rritje të çmimit të riskut, i cili miratohet nga AMF. Për më tepër konsumatorëve që udhëtojnë në Mal të Zi vazhdohet t'ju ofrohet karton jeshil me një çmim prej 62% më lirë se më parë.
  - Për eliminimin e policave fallco, tashmë policia e sigurimit karton jeshil është e vetmja policë e sigurimi që printohet me QR Code.
  - Nga ana e BSHS është ngritur sistemi i kontrollit elektronik në kufi të policave të sigurimit të pajisura me QR Code. BSHS është në proces të përfundimit të marrëveshjes tri palëshe, Drejtori e Përgjithshme e Policisë, AMF dhe BSHS, me qëllim lehtësimin e këtij kontrolli.
  - Në vazhdim të vendimit të Komitetit të Menaxhimit të Këshillit të Byrove, produkti karton jeshil risigurohet nga Shoqëritë e Sigurimit që prej vitit 2014 e në vijim, proces ky që ka sjell avantazhet, lidhur me besimin e Këshillit të Byrove ndaj Byrosë Shqiptare, kushte të njëjta të mbulimit të secilës shoqëri në rast aksidenti, mbulimi i risqeve në rastin e kartonave fallco, falimentin e një anëtari.
23. BSHS në vijim të shkresave nr. 236/4 prot., datë 27.04.2022 “Përcjellim informacionin në lidhje me Statusin e Monitorimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, dhe nr. 236/5 prot., datë 27.04.2022 “Përcjellim informacion në lidhje me funksionimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit në kuadër të anëtarësimit në Këshillin e Byrove dhe dinamika e vlerësimit të Statusit të Monitorimit”, bën me dije se:
24. Byroja Shqiptare e Sigurimit, ka paraqitur zyrtarisht kërkesë pranë Këshillit të Byrove, me qëllim vlerësimin e statusit dhe eventualisht daljen nga ky status. Në vlerësim të kërkesës së BSHS, Këshilli i Byrove ka verifikuar detajisht të gjithë treguesit në lidhje me funksionimin në tërësi të tregut të sigurimeve për produktin karton jeshil. Janë vlerësuar në nivel të kënaqshëm, treguesit dhe performanca e anëtareve në lidhje me pagesat dhe bashkëpunimin e treguar me të gjitha Byrotë Homologe.
25. Në lidhje me statusin e BSHS si 'Byro ne Monitorim', ka kërkuar zyrtarisht nga Këshilli i Byrove vlerësimin e këtij statusi dhe konsiderimin e mundësisë për daljen prej tij. Si kusht për daljen nga ky status është sugjeruar forcimi i fondit të garancisë që BSHS disponon, sugjerim i cili është miratuar dhe ndodhet në proces plotësimi nga anëtarët e Byrosë.
26. Në lidhje me garancitë financiare që kërkoj pjesëmarrja si anëtare në Këshillin e Byrove, aktualisht BSHS, ka të ngurtësuar në favor të Këshillit të Byrove dy garanci në shumat përkatëse të kërkuara, një prej të cilave në bankën Societte në Paris dhe tjetrën në përputhje me Ligjin nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Sipas BSHS nuk ka rezultuar kurrë e nevojshme për tu konsumuar asnjë pjesë e garancive të krijuara, për shkak edhe kjo të stabilitetit të anëtareve dhe të tregut.
27. Në kuadër të kësaj kërkesë ka parashtruar dhe përcjellë informacion të plotë e që lidhet me: i) stabilitetin financiar të anëtareve dhe tregut në tërësi; ii) ka sqaruar kuadrin rregullativ ligjor në vend, përsa i përket tregut të detyrueshëm të sigurimeve; iii) funksionimin e brendshëm të BSHS, iv) bashkëpunimin me Byrotë Homologe etj. Përveç informacionit ka përcjellë edhe dokumentacionin e domosdoshëm dhe të nevojshëm të kërkuar.

28. Në bazë të shkresës nr. 236/7 prot., datë 10.05.2022 “Konfirmimi i marrjes së kërkesës për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil”, drejtuar BSHS, është konfirmuar se dokumentacioni i dorëzuar është i plotë dhe do të nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 5 dhe nenet 48-52 të seksionit II (Procedura për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimit) të ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

## **VII. Kushtet dhe detyrimet**

29. Në bazë të nenit 50, pika 2 e ligjit nr. 9121/2003, vlerësojmë që kjo marrëveshje të jepet me kushte dhe detyrime me qëllim që të ketë konkurrencë të mjaftueshme në tregun përkatës dhe marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun dhe klientët të mos bien dakord për primet e shitjes, si më poshtë vijon:

- i. Afati i marrëveshjes të jetë 2 vjeçar;
- ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.

30. Ndryshimet e mësipërme synojnë reduktimin e mundësisë së koordinimit të sjelljes dhe kanë si qëllim të shmangin një ndarje potenciale të pjesëve të tregut mes palëve njoftuese të marrëveshjes dhe në këtë mënyrë respektohen parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 5, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

## **VENDOSI:**

1. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
  - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
  - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës.

3. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
4. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të kryen pagesat e parashikuara në rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 905, Datë 29.07.2022**

**“PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE SWIXX BIOPHARMA AG DHE SANOFI-AVENTIS GROUPE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”; Rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”; Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, lidhur me përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe,

**VËREN SE:**

**I. Procedura e ndjekur.**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është kërkuar përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe.

**Swixx Biopharma AG (Distributori)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kantonit Zug, Zvicër, me objekt aktiviteti: Tregtimi, konsulenca dhe ofrimi i përfaqësive në sektorin e shëndetësisë, mbështetja ndërmjetësuese dhe ofrimi i shërbimeve në të gjitha aktivitetet që lidhen me të, etj.

Distributori ushtron ndër të tjera, aktivitetin e ripaketimit, importit, promovimit, marketingut dhe shpërndarjes së produkteve farmaceutike dhe pajisjeve mjekësore.

Swixx Biopharma AG është një filial i Swixx Biopharma SA, një shoqëri farmaceutike ndërkombëtare me qendër në Zvicër dhe shoqëria mëmë e grupit të shoqërive Swixx (Swixx Group).

Swixx Biopharma AG është prezente në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë *Amicus Pharma SHPK*, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: si primar; Hulumtim i tregut dhe sondazh i opinionit publik,

marrëdhëniet me publikun dhe aktivitet e komunikimit, aktivitet e biznesit dhe aktivitet e tjera te konsulencës për menaxhimin, si dytësor; Kultivimi i erëzave, prodhimi i barnave, produkteve farmaceutike dhe bujqësore, prodhimi i produkteve farmaceutike bazë, prodhimi i preparateve farmaceutike, shitja me shumicë e mallrave farmaceutikë, etj.

**Sanofi-Aventis Groupe (Kontraktuesi)** është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit francez me seli në Paris, me objekt aktiviteti: Ofrim shërbimesh, marrje pjesëmarrjesh dhe themelim zyrash, degësh ose ndërmarrjesh që lidhen direkt ose indirekt me fushën e shëndetësisë.

Kontraktuesi ushtron ndër të tjera, aktivitetin e zhvillimit, prodhimit, certifikimit, hedhjen në treg dhe tregtimin e produkteve farmaceutike dhe pajisjeve mjekësore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në produktet e përcaktuara në Marrëveshjen e lidhur nga palët.

Sanofi-Aventis Groupe, është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet zyrës së saj të përfaqësimit, *Zyrë Përfaqësimi Sanofi – Aventis Groupe S.A.*, me objekt aktiviteti: Mbledhja dhe komunikimi i informacioneve shkencore, promovimi i aktiviteteve dhe produkteve të Sanofi - Aventis Groupe, kërkimi për nënkontraktorë të mundshëm në Shqipëri.

Zyra e përfaqësimit të Sanofit aktualisht është shoqëri me status në *likuidim e sipër*.

## II. Përshkrimi i marrëveshjes

Ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG (distributori) dhe Sanofi-Aventis Groupe (kontraktuesi), më datë 12 korrik 2021, është nënshkruar Kontrata Ekskluzive e Distribucionit, nëpërmjet të cilës Kontraktuesi emëron Distributorin si distributor ekskluziv për të importuar dhe shpërndarë produktet në *Territore* (si Shqipëri, Bosnjë, Bullgari, Kroaci, Estoni, Kosovë, Letoni, Lituani, Moldavi, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbi, Sllovakia, Slloveni) dhe Distributori pranon këtë emërim, sipas termave dhe në zbatim të kushteve të kësaj Kontrate. Distributori blen produktet ekskluzivisht nga Kontraktuesi ose nga një Filial i Kontraktuesit.

Sipas nenit 3.7 të Marrëveshjes “Produkte të Konkurrencës”, objekt i saj janë produkte farmaceutike, të cilat nuk shiten nga Kontraktuesi ose nga Filialet e Kontraktuesit, dhe që përmbajnë të njëjtët përbërës aktivë mono ose në kombinim, që përmban nëngrupi ATC3 që konkurrojnë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, me çdo produkt të listuar si produkt konkurrues sipas përcaktimeve në marrëveshje.

Marrëveshja e njoftuar, vlerësohet në zbatim të nenit 5 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në të cilin parashikohet përjashtimi individual nga zbatimi i nenit 4 të tij.

Marrëveshjet përjashtohen nga ndalimet e parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003 në rastet kur kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve dhe të konsumatorëve dhe kur:

- 1) Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;
- 2) Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.

Marrëveshja e depozituar klasifikohet si një marrëveshje vertikale, e cila në kuptim të neni 2 të rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, nënkupton një marrëveshje, apo praktikë të bashkërenduar, lidhur midis dy ose më shumë ndërmarrjeve, ku secila prej tyre vepron, për qëllimet e marrëveshjes ose praktikës së bashkërenduar, në një nivel të ndryshëm

të zinxhirit të prodhimit ose të shpërndarjes dhe në lidhje me kushtet në të cilat palët mund të blejnë, të shesin ose rishesin produkte ose shërbime të përcaktuara.

Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehen se janë të ndërgjegjësuar për zbatimin e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke shprehur angazhimin se nuk do të realizojnë kufizime që bien ndesh me nenin 4 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke qenë të mendimit se marrëveshja nuk kufizon konkurrencën përtej asaj që është ngushtësisht e nevojshme për të arritur qëllimin e marrëveshjes dhe rezultateve të parashikuara të bashkëpunimit duke mos kryer asnjë veprim që mund të çënojë pozitën në treg, imazhin, ose reputacionin e Produktit, Markës Tregtare ose Kontraktuesit ose secilit për Filialet e tij dhe do të bëjë përpjekjet maksimale për të promovuar dhe zhvilluar emrin dhe imazhin e markës së Kontraktuesit, për të rritur ndërgjegjësimin në treg dhe shitjen e produkteve brenda Territorit të parashikuar në marrëveshje.

Për sa më sipër, marrëveshja e njoftuar klasifikohet si një marrëveshje vertikale mes një furnizuesi dhe një distributori e cila ka për qëllim shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike të gatshme brenda klasave ATC3 (A10H dhe A10C).

### III. Analiza e konkurrencës

Sipas marrëveshjes, Sanofi cakton Swixx si distributorin e saj ekskluziv për shpërndarjen e produkteve vetëm me recetë (RX) të Sanofit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Estoni, Kosovë, Letoni, Lituani, Moldavi, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Sllovaki, Slloveni.

Shpërndarja e produkteve në Shqipëri do të organizohet nga Sanof përmes kanaleve të zakonshme të shpërndarjes në nivel vendor që do të thotë se subjektet e huaja që i përkasin Sanofi Group do t'i shesin produktet Swixx-it dhe në vijim, Swixx do t'i rishesë më tej këto produkte te tregtarët e saj ekzistues vendas të autorizuar me shumicë/ importuesit e produkteve farmaceutike në Shqipëri.

Sanofi synon të ketë, nëpërmjet partnerit të saj, Swixx, aktivitete tregtare dhe marketing, përveç të gjitha shërbimeve të kërkuara në nivel lokal. Kjo është në përputhje me angazhimin e Sanofit që në tregun shqiptar, të sigurojë akses të vazhdueshëm të konsumatorit në barnat e Sanofit.

Referuar nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës” dhe marrëveshjes së depozituar, u analizua tregu përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit përcaktohet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.

Mbështetur në analizën e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës dhe kërkesës, si dhe rasteve të ngjashme të trajtuara nga autoritete të konkurrencës në tregun farmaceutik, u konstatua se çdo bar xhenerik, është një bar i destinuar për kurimin e një sëmundjeje specifike dhe është i pazëvendësueshëm nga barnat e tjerë xhenerik. Mbi principin aktiv të barit xhenerik dhe shitjes së patentës së tij nga mbajtësit e saj, ndërmarrjet prodhuese farmaceutike krijojnë barnat alternativë të cilët janë zëvendësues të njëri- tjetrit për sa kohë sigurojnë të njëjtën substancë aktive të barit. Parë në këtë këndvështrim, të gjithë barnat alternativë (tregtarë) janë zëvendësues të njëri- tjetrit, brenda barit xhenerik. Për këto arsye, tregu përkatës i produktit do të përcaktohet në nivelin e barit xhenerik.



Marrëveshja ka të përcaktuar që barnat objekt i saj, i përkasin klasifikimit ATC3 dhe konkretisht klasave A10H dhe A10C dhe për këto arsye, treg përkatës i produktit, i prekur nga marrëveshja e njoftuar, do të konsiderohet tregu për shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike të gatshme të klasave A10H dhe A10C sipas sistemit ATC (barna antidiabetikë).

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën ku ndërmarrjet palë në marrëveshje përfshihen në ofertën dhe kërkesën e produkteve përkatëse, ku kushtet e konkurrencës janë homogjene dhe mund të dallohen nga zonat gjeografike fqinje, sepse në mënyrë të veçantë, kushtet e konkurrencës janë mjaft të ndryshme nga ato zona.

Rrjedhimisht treg përkatës gjeografik do të përcaktohet territori kombëtar i Republikës së Shqipërisë.

#### **a. Pjesët e tregut**

Importi, tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve farmaceutike në Shqipëri është një treg i rregulluar. Tregtimi i barnave i nënshtrohet pajisjes me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe çmimet e barnave rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Regjistrimi, shpërndarja dhe tregtimi i barnave është gjithashtu i rregulluar dhe kërkon marrjen e miratimit paraprak, kërkesa të veçanta për magazinimin, transportin dhe shpërndarjen, pajisjet dhe personelin e nevojshëm dhe kontrollin mbi zinxhirin e furnizimit deri tek tregtimi me pakicë i barit.

Shoqëritë Sanof dhe Swixx nuk importojnë dhe shpërndajnë produkte direkt në nivel vendor me shumicë ose në shitje direkt në farmaci ose spitale, pasi të dyja palët i tregtojnë produktet e tyre në Shqipëri nëpërmjet shoqërive të autorizuara nga Ministria e Shëndetësisë për importin dhe shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike si R&S Farma, Rejsi Farma, Delta Pharma etj.

Barnat e përfshira në tregun përkatës të produktit i përkasin kategorisë së barnave antidiabetikë, të përdorur nga të sëmurë kronikë, të cilat janë të përfshira në listën e barnave të rimbursueshme, ku çmimi i barit mbulohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FONDI).

Nga sa deklarohej nga pala njoftuese, në lidhje me tregun e shitjes së barnave<sup>3</sup> në Shqipëri, rezulton se shoqëria Swixx nuk tregton produktet farmaceutike të gatshme brenda klasifikimit ATC3 (klasa A10H dhe A10C) dhe pjesa e tregut e blerësit (Swixx) është zero, ndërkohë që kontraktuesi zotëron nga 30-60% sipas klasave specifike.

Në tregun shqiptar, Swixx ka vetëm 6 produkte të autorizuara për tregtim të cilat i përkasin klasave L02B, J06B, B05A dhe J01M. Nisur nga kjo, edhe pse palët në marrëveshje shpërndajnë produkte brenda sistemit të klasifikimit ATC3, këto produkte i përkasin klasave të ndryshme të ATC3 duke mos sjellë mbivendosje të aktivitetit të palëve ndërmjet produkteve Swixx dhe Sanof në Shqipëri, në tregun përkatës të produktit.

#### **b. Vlerësimi i marrëveshjes**

Referuar nenit 5 të rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, marrëveshja e njoftuar nuk ka të parashikuar klauzola të cilat të fiksojnë çmimin, ndajnë tregjet apo kufizojnë prodhimin, sjellje këto të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003. Gjithashtu kjo marrëveshje nuk do të ndryshojë strukturën e tregut në vend, duke mos kufizuar,

<sup>3</sup> Agjencia e paravurr IQVIA- [www.iqvia.com/about-us](http://www.iqvia.com/about-us)

shtrembëruar apo parandaluar konkurrencën në tregun përkatës.

Duke pasur parasysh që pjesa mbizotëruese e aktiviteteve të kërkim zhvillimit, prodhim dhe shitje me shumicë zhvillohet jashtë vendit, nga shoqëria farmaceutike ndërkombëtare me kapital dhe burime të konsiderueshme kërkimore, ka shumë barna dhe trajtime që nuk janë ende në dispozicion në Shqipëri, por potencialisht mund të hyjnë në tregun shqiptar brenda një periudhe të arsyeshme dhe bëhen konkurrentë në klasat përkatëse ATC3.

Ekzistenca e më shumë se një ofruesi të produkteve ekzistuese brenda klasës A10 tregon se tregu është dinamik dhe pjesëmarrjet aktuale të tregut brenda grupit të caktuar të produkteve xhenerike ATC3 nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht një pozicion afatgjatë në treg, i cili (pra pjesëmarrja në treg) ndryshohet shpesh dhe varet nga investimi i tregut në produktet farmaceutike.

Në çdo rast, Marrëveshja nuk ndikon në pjesëmarrjen në treg të Sanofit në lidhje me Produktet e Përrjashtimit, pasi tregu i produkteve Swixx me recetë (RX) në Shqipëri nuk mbivendoset me klasat ATC3 të produkteve të Sanofit.

Pas implementimit të Marrëveshjes, kushtet konkurruese të tregut do të mbeten të njëjta sepse Swixx Biopharma do të shpërndajë Produktet brenda portofolit të produkteve që jepen me recetë nga mjeku i Sanofit, produkte të cilat më parë Sanofi-Aventis Groupe i shpërndante përmes rrjetit të vet të shpërndarës në Shqipëri (shitësve me shumicë të autorizuar).

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe.
2. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 906, Datë 29.07.2022

### “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN KU USHTROJNË VEPRIMTARINË SFJB”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i Raportit “Raporti i hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka”

**Baza Ligjore:** Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 43, neni 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Raportit të hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka,

## VËREN SE :

### I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, ka vendosur hapjen e procedurave të hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka.
2. Me vendimin e KK nr.772, datë.11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, u vendos hapja e procedurës së hetimit të thelluar, për shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndaj ndërmarrjeve:
  - Fondi Besa SHA në tregun e kredisë;
  - Iute Credit Albania SHA në tregun e mikrokredisë;
  - Tirana Factoring & Lease SHA në tregun e faktoringut;
  - Mogo Albania SHA dhe Raifeisen Leasing SHA në tregun e qirasë financiare
  - Unioni Financiar i Tiranës SHA në tregun e parasë elektronike, shërbimit të pagesave dhe transferimit të parave (kombëtare dhe ndërkombëtare).
3. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 799, datë 06.05.2021 “Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë Fondi Besa SHA për shfuqizimin e vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së

hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, vendosi rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes Fondi Besa SHA.

4. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 798, datë 06.05.2021 “Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë UFT SHA për shfuqizimin e vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes UFT SHA.
5. KK me vendimin nr. 797, datë 06.05.2021 “Rrëzimi i kërkesës së shoqërisë Iute Credit Albania SHA për rivlerësimin e vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes Iute Credit Albania SHA.
6. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar u konstatua se nga ana e SFJB nën hetim, të dhënat lidhur me volumin e portofolit për vitet 2018, 2019 dhe 2020 për produktin qira financiare, rezultojnë të jenë të ndryshme nga të dhënat e administruara gjatë hetimit paraprak, fakt i cili bën që të ndryshojë struktura e tregut për ndërmarrjet në tregun e qirasë financiare. KK me vendimin nr. 838, datë 29.09.2021 “Për një shtesë në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, me qëllim realizimin e një analize të plotë të ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e qirasë financiare, ka vendosur hapjen e hetimit të thelluar edhe për shoqërinë Raiffeisen Leasing SHA për të vlerësuar nëse ka shkelje të mundshme të nenit 9 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
7. Subjekt financiar jobankë është personi juridik që licencohet nga BSH, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare. Mbikëqyrja e SFJB në Shqipëri fillon që me procesin e licencimit dhe plotësimin e kriterëve për licencimin. Procesi i licencimit mbështetet në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për licencimin e SFJB, për të ushtruar veprimtaritë financiare të tilla si:
  - Kredi dhënia;
  - Faktoringu;
  - Qiraja financiare;
  - Të gjitha format e pagesave dhe të transferimit të parave;
  - Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;
  - Këmbimi valutor;
  - Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e përmendura më sipër.
  - Licencimin e institucionit financiar të mikrokredisë;
  - Licencimin e institucionit të parasë elektronike, ku ky subjekt mund të ushtrojë edhe një ose disa nga këto veprimtari:
    - të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

- Këmbimi valutor;
- Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar.

## II. ANALIZA E KONKURRENCËS

8. Përcaktimi i tregut përkatës është elementi kryesor i analizës së konkurrencës. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121/2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, “*tregu përkatës përbëhet nga produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese*”. Përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.
- **Tregu përkatës i produktit:** Sa më sipër, treg përkatës i produktit do konsiderohet tregu ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo bankë: tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimi i pagesave dhe transfertave, paraja elektronike.
  - **Tregu përkatës gjeografik:** treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.
9. Tregu ku ushtrojnë veprimtarinë SFJB është treg i rregulluar dhe mbikëqyret nga BSH, e cila licencën, rregullon dhe mbikëqyr SFJB në tregjet përkatëse, si dhe publikon në kuadër të transparencës, interesat dhe komisionet tre mujore për çdo SFJB.
10. Në këtë hetim, treg përkatës i produktit konsiderohet tregu ku ushtrojnë veprimtarinë SFJB: tregu i kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimi i pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike.
11. Nga ana e SFJB-ve kërkohet plotësimi i kriterëve financiarë dhe ligjorë për licencim nga BSH, pra mund të themi se ka barriera në hyrje.
12. **Në tregun e kredisë:** Nga vlerësimi i strukturës së tregut konstatohet se tregu është shumë i përqendruar dhe Fondi Besa SHA zotëron mbi 60% të tregut. Fondi Besa SHA, është një ndërmarrje më një eksperiencë disa vjeçare në treg, e cila ka arritur të zgjerojë rrjetin e shpërndarjes, duke pasur zyra në gjithë territorin e RSH. Për periudhën objekt hetimi, nuk vërehen hyrës të rinj në treg. Për sa më sipër bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Fondi Besa SHA ka pozitë dominuese në tregun e kredisë.
- Nga analiza e sjelljes së Fondit Besa SHA, në lidhje me aplikimin e normave mesatare mujore, konstatohet se norma e aplikuar është më e larta për periudhën nën hetim.
  - Nga analiza e komisioneve dhe penalteteve të aplikuara nga Fondi Besa SHA, konstatohet se këto tarifa kanë qenë në rënie për periudhën nën hetim.
- Për sa më sipër, sjellja e Fondit Besa nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma a) të ligjit 9121/2003. \_

- Fondi Besa SHA nuk ka aplikuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta më palët huamarrëse, duke i vendosur në kushte të pavaforshme konkurrence, sjellje e cila nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma c) dhe ç) të ligjit 9121/2003.

13. **Në tregun e mikrokredisë:** Nga vlerësimi, lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut, konstatohet se ndërmarrja Iute Credit Albania SHA, pjesa e tregu në periudhën hetimore, është mbi 58% të tregut, dhe tregu është shumë i përqendruar. Në periudhën objekt hetimi, nuk vërehen hyrës të rinj në treg. Lidhur me rrjetin e shpërndarjes, vihet re se subjekti Iute Credit Albania SHA, ka 6 pika të ofrimit të produktit në Tiranë dhe nga 1 pikë në qytetet Fier, Vlorë, Korçë, Berat, Shkodër dhe Durrës. Për sa më sipër bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Iute Credit Albania SHA ka pozitë dominuese në tregun e mikrokredisë.

- Nga analiza e sjelljes së Iute Credit Albania SHA, në lidhje me aplikimin e normave mesatare mujore, konstatohet se normat e aplikuara të interesit nuk janë më të lartat në tregun e mikrokredisë për periudhën nën hetim.
- Nga analiza e komisioneve dhe penaliteteve, konstatohet se Iute Credit Albania SHA nuk aplikon tarifat më të larta për periudhën nën hetim.

Për sa më sipër, sjellja e Iute Credit Albania SHA, nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, germa a) të ligjit 9121/2003.

- Iute Credit Albania SHA nuk ka aplikuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta më palët huamarrëse, sjellje e cila nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, germa c) dhe ç) të ligjit nr. 9121/2003.

14. **Në tregun e faktoringut:** Nga vlerësimi i strukturës së tregut konstatohet se tregu është shumë i përqendruar dhe se Tirana Factoring & Lease SHA zotëron mbi 50%. Lidhur me konkurrencën potenciale në treg, në periudhën objekt hetimi, në periudhën objekt hetimi, vihet re se ka patur hyrje dhe dalje të ndërmarrjeve nga tregu. Për sa më sipër bazuar në bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Tirana Factoring & Lease SHA ka pozitë dominuese në tregun e faktoringut.

- Nga analiza e sjelljes së Tirana Factoring & Lease SHA, në lidhje me aplikimin e normave mesatare mujore të interesit, konstatohet se normat e aplikuara janë në nivele të ulta, në nivelin 1%, për periudhën nën hetim.
- Nga analiza e sjelljes së Tirana Factoring & Lease SHA, në lidhje me komisionet e aplikuara për faktoringun, rezulton se komisionet janë në nivele të ulta krahasuar me SFJB-të e tjera për periudhën nën hetim.

Për sa më sipër, sjellja e Tirana Factoring & Lease SHA nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma a) të ligjit 9121/2003 për tregun e Faktoringut.

- Tirana Factoring & Lease SHA nuk ka aplikuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta më palët që marrin shërbimin e faktoringut, sjellje e cila nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma c) dhe ç) të ligjit 9121/2003.

15. **Në tregun e qirasë financiare:** Nga vlerësimi i strukturës së tregut konstatohet se tregu është shumë i përqendruar dhe se Raiffeisen Leasing SHA zotëron rreth 40% të tregut. Në tregun e qirasë financiare nuk ka patur qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë periudhës nën hetim. Lidhur me konkurrencën potenciale në treg, në periudhën objekt hetimi, nuk vërehen hyrës të rinj në treg.

Për sa më sipër bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, Raiffeisen Leasing SHA ka pozitë dominuese në tregun e qirasë financiare.

- Ndërmarrja Raiffeisen Leasing SHA, e cila ka dhe pjesën më të madhe të tregut për produktin e qirasë financiare ka norma interesi nga 5-5.5%, të cilat janë më të ulëta krahasuar me normat e interesit që ofrojnë SFJB-të e tjera.
- Nga analiza e sjelljes së Raiffeisen Leasing SHA, në lidhje me aplikimin e normave mesatare mujore të interesit për produktin qira financiare, konstatohet se normat e aplikuara janë në nivelin nga 4.35%-5.73%, norma më të ulëta së SFJB e tjera për periudhën nën hetim. Në lidhje me komisionet e aplikuara për produktin qira financiare, rezulton se për Raiffeisen Leasing SHA komisionet janë në nivele të larta krahasuar me SFJB-të e tjera për periudhën nën hetim.

Për sa më sipër, sjellja e Raiffeisen Leasing SHA nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma a) të ligjit nr. 9121/2003 për tregun e Qirasë Financiare.

- Nga vlerësimi i kontratave të administruara nga ana e AK në këndvështrim të ligjit nr. 9121/2003 rezulton se Raiffeisen Leasing SHA nuk ka aplikuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta më palët sjellje e cila nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma c) dhe ç) të ligjit nr. 9121/2003.

**16. Në tregun e parasë elektronike:** Nga vlerësimi lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut të parasë elektronit, konstatohet se ndërmarrja UFT SHA zë mbi 90% të tregut. Lidhur me konkurrencën potenciale në treg, në periudhën objekt hetimi, nuk vërehen hyrës të rinj në treg. UFT SHA ka një rrjet të gjerë shpërndarje në treg mbi 600 pika në të cilat ofron shërbimet e saj, është një ndërmarrje më një eksperiencë disa vjeçare në treg, duke arritur të zgjerojë rrjetin e shpërndarjes dhe duke pasur zyra në gjithë territorin e RSH. Në tregun e parasë elektronike vihet re se ka një lidhje vertikale me UFT SHA me Bankën Union pasi UFT SHA cili operon në tregun e parasë elektronike, dhe zotëron pozitë dominuese në këtë treg, zotëron 100% të Union Bank SHA, bankë e nivelit të dytë që operon në tregun bankar.

Për sa më sipër bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, UFT SHA ka pozitë dominuese në tregun e parasë elektronike.

- Konstatohet se tregu i parasë elektronike për të cilin është licencuar dhe operon UFT SHA është i lidhur me tregun e shërbimit të pagesave dhe transferimin e parave. Në tregun e parasë elektronike UFT SHA nuk aplikon komisione apo tarifa lidhur me këtë produkt për periudhën nën hetim. Për sa më sipër, sjellja e UFT SHA nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma a) të ligjit 9121/2003.
- Parë në këndvështrimin e nenit 9 të ligjit 9121/2003, pika 2, gërma c), nuk evidentohen të jenë parashikuar, kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta më palët, duke i vendosur në kushte të pafavorshme konkurrence.

**17. Në tregun e shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare:** Nga vlerësimi lidhur me strukturën dhe pjesët përkatëse të tregut të shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare, konstatohet se ndërmarrja UFT SHA zë mbi 70% të tregut të pagesave dhe mbi 80% të tregut të transfertave ndërkombëtare dhe kombëtare. Lidhur me konkurrencën potenciale në treg, në periudhën objekt hetimi, nuk vërehen hyrës të rinj në treg. UFT SHA ka një rrjet të gjerë shpërndarje në treg mbi 600 pika në të cilat ofron shërbimet

e saj, është një ndërmarrje më një eksperiencë disa vjeçare në treg, duke arritur të zgjerojë rrjetin e shpërndarjes dhe duke pasur zyra në gjithë territorin e RSH.

- Në tregun e shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare, vihet re se ka një lidhje vertikale me e UFT me Bankën Union pasi UFT cili operon në këtë treg, dhe zotëron pozitë dominuese në këtë treg, zotëron 100% të Union Bank SHA, bankë e nivelit të dytë që operon në tregun bankar.

Për sa më sipër bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, UFT SHA ka pozitë dominuese në tregun e tregut të shërbimit të pagesave, transfertave ndërkombëtare dhe transfertave kombëtare. UFT SHA nuk ka aplikuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta më palët, duke i vendosur në kushte të pavaforshme konkurrence, sjellje e cila nuk bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 9, pika 2, gërma a), c) dhe ç) të ligjit 9121/2003.

18. Vlerësojmë se BSH është organi rregullator i tregut në të cilin operojnë subjektet financiare jo banka. Konstatohet se ashtu si dhe legjislacioni parësor, edhe legjislacioni dytësor që rregullon aspekte të veçanta lidhur me funksionimin e tregut të SFJB dhe transparencën, gjenden të integruara në të njëjtin akt nënligjor si për subjektet financiare-Banka ashtu edhe për SFJB. Për sa më sipër vlerësojmë se BSH duhet të hartojë raporte mbikëqyrjeje të veçanta për SFJB duke përcaktuar pjesët respektive të tregut për secilin SFJB në tregun ku ajo operon, t'i publikojë dhe t'i bëjë transparente ato si dhe të bashkëpunojë me AK në rastet kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës, në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003.

19. Lidhur me mirëfunksionimin dhe rregullimin e këtij tregu vlerësojmë se BSH duhet të hartojë një akt nënligjor të dedikuar për SFJB në tregun përkatës ku ato ushtrojnë veprimtarinë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 43, nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

### **VENDOSI:**

1. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB).
2. T'i rekomandojë SFJB që operojnë në treg, respektimin e dispozitave të nenit 9 të ligjit nr.9121/2003.
3. T'i rekomandojë Bankës së Shqipërisë, si organi rregullator i tregut në të cilin operojnë SFJB:
  - a. Të hartojë raporte mbikëqyrjeje të veçanta për SFJB duke përcaktuar pjesët respektive të tregut për secilin SFJB në tregun ku ajo operon, ti publikojë dhe ti bëjë transparente ato.
  - b. Të hartojë një rregullore të veçantë për përcaktimin dhe miratimin e rregullave për kredinë konsumatore, mikrokredinë, faktoringun, qiranë financiare për mirëfunksionimin e tregut ku operojnë SFJB.



c. Të bashkëpunojë me AK në rastet kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës, në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURENCËS**

## VENDIM

Nr. 907, Datë 09.09.2022

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT MBI SHOQËRINË VIANODE AS NGA SHOQËRITË ELKEM ASA, HYDRO ENERGI INVEST AS DHE ALTOR FUND V (NR. 1 DHE NR. 2) AB.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.09.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Vianode AS nga shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS dhe Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Vianode AS nga shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS dhe Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB.

### VËREN SE :

#### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi mbi përfimin e kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Vianode AS nga shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS dhe Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB.

Referuar “Marrëveshjes së Investimit” dhe “Marrëveshjes së Aksionarëve” të lidhura më datë 06 prill 2022, palët janë:

#### Blerësit:

**Hydro Energi Invest AS** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Norvegjisë. Hydro Energi Invest AS është në pronësi të plotë të shoqërisë Hydro Energi AS, e cila kontrollohet nga shoqëria Norsk Hydro ASA, shoqëri norvegjeze. Norsk Hydro ASA është shoqëria mëmë

e Grupit Hydro, e listuar në Bursën e Oslos, e cila është pjesërisht në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Hydro po zhvillon bizneset e tij në industrinë e prodhimit të aluminit (minierat e boksitit dhe rafinimi i aluminit, alumini primar, nxjerrjet e aluminit dhe riciklimi i aluminit).

Grupi Hydro nuk ka filiale, degë, zyra përfaqësuese apo aktivitete në Shqipëri dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2021.

**Altor Fund V (Nr.1) AB** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Suedisë.

**Altor Fund V (Nr.2) AB** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Suedisë. Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr. 2 AB) është një fond kapitali privat, i cili fokusohet në investimet në ndërmarrje të mesme të rajonit nordik. Altor Fund V menaxhohet nga Altor Fund Manager AB, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas ligjeve të Suedisë, i cili është nën mbikëqyrjen e Autoriteteve Suedeze të Mbikëqyrjes Financiare si menaxher i autorizuar i fondeve të investimeve alternative.

Altor Fund Manager AB është pjesë e Grupit Altor, e cila ka në Shqipëri një filial – Transcom Worldwide Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ofrimin e linjave elektronike ndihmëse shumëgjuhëshe për klientin dhe shërbim suporti për çdo aktivitet, ofrimin e shërbimeve tregtare dhe aktiviteteve mbështetëse etj.

**Shitësi: ELKEM ASA** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Norvegjisë. ELKEM ASA është një prodhues i silikonëve, lidhjeve për industrinë e shkrirjes, karbonit dhe mikrosilikateve dhe një ofrues global i zgjidhjeve të materialeve të avancuara. ELKEM ASA është e angazhuar drejtpërdrejt dhe nëpërmjet filialeve të saj dhe shoqërive të sipërmarrjes së përbashkët, në prodhimin, shitjen, marketingun dhe kërkimin dhe zhvillimin e silikonit, ferrosilikonit dhe lidhjeve të specializuara me bazë ferro-silikon për shkrirjen e hekurit dhe industrinë e çelikut dhe biznese të tjera të ngjashme.

ELKEM ASA është listuar në bursën e Oslos dhe kontrollohet në masën 52.91% nga shoqëria Bluestar Elkem International Co. LTD., S.A. dhe pjesa tjetër prej 47.1% kontrollohet nga aksionarë të tjerë. Bluestar është një shoqëri e specializuar në materiale kimike dhe kimikate të specializuara, me operacione në një sërë vendndodhjesh me seli në Pekin, Kinë. Bluestar është në pronësi dhe kontrollohet tërësisht nga Sinochem Holdings Co., Ltd (Sinochem Holding Group).

Sinochem Holding Group nuk ka filiale të themeluara në Shqipëri.

**Target: Vianode AS** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Norvegjisë. Vianode është një prodhues i materialeve të qëndrueshme të baterive anode. Shoqëria prodhon materiale, anode aktive, me fokus në materialet sintetike me bazë grafit dhe kompozitat potencialisht silikon-grafit. Aktualisht Vianode AS është në pronësi të plotë të ELKEM ASA.

Vianode AS nuk ka filiale, degë, zyra përfaqësuese apo aktivitete në Shqipëri dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2021.

## II. Përqendrimi

Më datë 06 prill 2022, shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS, Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB dhe Vianode AS kanë nënshkruar “Marrëveshjen e Investimit” dhe “Marrëveshjen e Aksionarëve”.

Referuar Marrëveshjes së Investimit, shoqëria Vianode AS do të emetojë për shoqërinë ELKEM SA dhe shoqëritë Hydro Energi Invest AS, Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB, 400,450 aksione të reja, ku secili aksion do të jetë në vlerën 15.5581289 NOK.

Në përfundim të transaksionit dhe pas emetimit të aksioneve të reja, Vianode AS do të zotërohet 40% nga ELKEM ASA, 30% nga Hydro Energi Invest AS dhe 30% nga Altor Fund V (Nr.1) dhe (Nr. 2) AB.

Bazuar në Marrëveshjen e Aksionarëve, Bordi i Drejtorëve fillimisht do të përbëhet nga 6 drejtorë, ku secili aksionar që zotëron më shumë se 25% të aksioneve ka të drejtë të emërojë 2 anëtarë të Bordit. Çdo anëtar i Bordit ka një votë në lidhje me çështjet e votuara dhe kryetari nuk do të ketë një votë vendimtare.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët, mbi shoqërinë Vianode AS, nga shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS dhe Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB, i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e Konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i zhvillimit dhe prodhimit të materialeve aktive të anodës për prodhimin e baterive, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të përbashkët, mbi shoqërinë Vianode AS nga shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS dhe Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB.

Hydro Energi Invest AS dhe Sinochem Holding Group nuk kanë filiale të themeluara në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri gjatë vitit 2021.

Grupi Hydro nuk ka filiale, degë, zyra përfaqësimi apo aktivitet dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në vitin 2021 në Shqipëri.

Grupi Altor ka një filial në Shqipëri, shoqërinë Transcom WorldWide Albania SHPK.

Vianode AS nuk ka filiale, degë, zyra përfaqësimi apo aktivitet dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur në vitin 2021 në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje në tregje horizontale ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Vianode AS nga shoqëritë ELKEM ASA, Hydro Energi Invest AS dhe Altor Fund V (Nr.1 dhe Nr.2) AB.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 908, Datë 09.09.2022

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË VISHNUPRIYA FARMS PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRITË STATKRAFT IH HOLDINGS AS DHE STATKRAFT INDIA PRIVATE LIMITED”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.09.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëritë Statkraft IH Holdings AS dhe Statkraft India Private Limited.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëritë Statkraft IH Holdings AS dhe Statkraft India Private Limited.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëritë Statkraft IH Holdings AS dhe Statkraft India Private Limited.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përkohshëm të transaksionit të synuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited, nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS (Statkraft), Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr.901, datë 29.07.2022 “Mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Me shkresën nr. 492/5, datë 26.08.2022 “Njoftim përqendrimi”, përfaqësuesi ligjor ka njoftuar se shoqëria Statkraft IH Holdings AS dhe Statkraft India Private Limited kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerje aksionesh”, datë 04 gusht 2022, mbi blerjen e aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited.

Referuar Marrëveshjes, palët në marrëveshje janë:

#### **Pala blerëse:**

**Blerësi 1:** Statkraft IH Holdings AS, është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, dhe objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme.

Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS, pjesë e Statkraft Group. Grupi Statkraft është prodhuesi më i madh i energjisë së rinovueshme në Norvegji dhe prodhuesi i tretë më i madh i rajonit Nordik.

**Blerësi 2:** Statkraft India Private Limited, është një shoqëri, e themeluar dhe ekzistuese, sipas legjislacionit të Nju Dehli, Indi. Shoqëria kryen kryesisht operacionet e saj nga Delhi.

Shoqëria Statkraft IH Holdings AS dhe shoqëria Statkraft India Private Limited zotërohen 100% nga Grupi Statkraft.

Grupit Statkraft, është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

**Shoqëria Target:** Vishnupriya Fams Private Limited, është një shoqëri jo-qeveritare me aksione të kufizuara sipas legjislacionit të Indisë. Shoqëria është e zotëruar nga Silvergates Holdings and Investments Private Limited (99.9%) dhe një ortak i nominuar (0.1%).

Shoqëria target nuk ka prezencë dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri pasi të gjitha aktivitetet e saj bazohen vetëm në Indi.

#### **Pala shitëse:**

**Shitësi 1:** Silvergates Holdings & Investment Private Limited, është një shoqëri e themeluar, sipas legjislacionit të Indisë, shoqëri jo-qeveritare me aksione të kufizuara.

Shoqëria Silvergates Holdings & Investment Private Limited, është e përfshirë në aktivitete të tilla si: Ndërmjetësimi financiar, përveç sigurimit dhe pensionit, Aktivitetet e Fondeve të Ndërsjella duke përfshirë Unit Trust of India.

**Shitësi 2:** Z. Prashanth Krishnan, rezident dhe qytetar i Indisë.

## **II. Përqendrimi**

Në datë 04 gusht 2022, është nënshkruar “Marrëveshja për blerjen e aksioneve”, ndërmjet shoqërisë Statkraft IH Holdings AS (blerësi nr.1), Statkraft India Private Limited (blerësi nr.2), Silvergates Holdings & Investment Private Limited (shitësi) dhe Vishnupriya Farms Private Limited (target).

Referuar marrëveshjes, shitësit së bashku zotërojnë 100% të të gjithë kapitalit aksionar të emetuar, të nënshkruar dhe të paguar të shoqërisë, e lirë dhe e pastër nga çfarëdo barrë dhe sipas nenit 2, “Shitja dhe blerja e kuotave në shitje” dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, Shitësi nr.1 pranon dhe gjithashtu merr përsipër shitjen, transferimin, dorëzimin e kuotave të shitësit nr.2 tek blerësit dhe blerësit. Duke u mbështetur në garancitë dhe angazhimet e shitësit nr.1, blerësit pranojnë të blejnë nga shitësit kuotat në shitje të lira dhe të pastra nga çfarëdo barrë.

Me realizimin e shitjes dhe blerjes së kuotave në shitje në datën e mbylljes, blerësit do të mbajnë 100% të kapitalit të emetuar, të nënshkruar dhe të paguar plotësisht të shoqërisë. Në datën e mbylljes, kuotat në shitje do të shiten dhe transferohen blerësve me të gjitha të drejtat, titujt, interesat dhe privilegjet e shitësve.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e Konkurrencës**

Mbështetur në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë solare (diellore), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Statkraft IH Holdings AS dhe shoqëria Statkraft India Private Limited zotërohen 100% nga Grupi Statkraft, i cili është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

- Shoqëria Statkraft Renewables Albania SHPK, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e licensuar për prodhimin e energjisë nëpërmjet centraleve fotovoltaike me një kapacitet 2 MW dhe gjatë vitit 2021 ka gjeneruar 13 MWh duke zotëruar më pak se 0.1% në tregun e prodhimit të energjisë diellore.

- Shoqëria Devoll Hydropower SHA, është shoqëri aksionare me objekt planifikimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e njërive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit nëpërmjet HEC-eve “Banjë” dhe “Moglicë”, të cilat kanë prodhuar gjatë vitit 2021 683 mijë MWh, duke zotëruar 8% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike nga uji.

Vishnupriya Farms Private Limited është një shoqëri e regjistruar në Indi, aktive në prodhimin e energjisë solare. Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri. Aktiviteti i tij fokusohet në Indi. Blerja e tij është thelbësore në ngritjen e një projekti të dytë solar në Tamil Nadu.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,



**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëritë Statkraft IH Holdings AS dhe Statkraft India Private Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 910, Datë 26.09.2022

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SIKKIM HYDRO POWER VENTURES LTD. NGA SHOQËRIA STATKRAFT IH HOLDINGS AS”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.09.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr.899, datë 15.07.2022, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 477/5, datë 14.09.2022 “Njoftim përqendrimi”, jemi njoftuar se shoqëria Statkraft IH Holdings AS ka lidhur “Marrëveshje për blerje aksionesh”, me qëllim blerjen e aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd.

Referuar “Marrëveshjes për blerje aksionesh”, e nënshkruar datë 02 shtator 2022, palët janë:

**Pala blerëse:** Statkraft IH Holdings AS, është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme. Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit), në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike..etj.

*Devoll Hydropower SHA*, shoqëri aksionare me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

**Shoqëria Target:** Sikkim Hydro Power Ventures Ltd., është një shoqëri e regjistruar në Mumbai, Maharashtra, Indi. Target është një entitet i krijuar me një qëllim të veçantë nga Gammon Group në vitin 2005, për ndërtimin e një projekti të prodhimit të energjisë hidrike në lumin Rimbi Khola në Sikkim (Veri-Lindje e Indisë). Fokusi i target është ndërtimi dhe operimi i projekteve hidrike dhe furnizimi me energji i konsumatorëve.

Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

**Pala shitëse:** AJR Infra and Tolling Ltd, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë. AJR Infra And Tolling Limited ("AJRITL") është një shoqëri e zhvillimit të projekteve infrastrukturore e promovuar nga Gammon India Limited, për të marrë pjesë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës mbi bazën e partneritetit publik privat ("PPP").

## II. Përqendrimi

Referuar “Marrëveshjes për blerje aksionesh”, që nga data e nënshkrimit, shitësi ka pronësinë ligjore dhe përfituese që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë target pa asnjë barrë. Duke u mbështetur në garancitë, marrëveshjet edhe angazhimet e palëve, blerësi ka rënë dakord të blejë dhe shitësi ka rënë dakord të shesë dhe ti dorëzojë blerësit aksionet që tregtohen pa asnjë barrë dhe së bashku me të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat mbi to pas pagesës së shumës së shitjes në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Detyrimi i blerësit për të blerë aksionet që tregtohen dhe për ti paguar shitësit shumën e shitjes në datën e mbylljes, do të kushtëzohet me përmbushjen nga shitësi, në një formë dhe mënyrë të pranueshme për blerësin, ose me heqjen dorë me shkrim nga blerësi sipas gjykimit të tij, të të gjitha kushteve të përcaktuara (Kushtet Paraprake).

Menjëherë pas përmbushjes së Kushteve Paraprake, shitësi do të njoftojë blerësin për përmbushjen e të gjitha Kushteve Paraprake duke dorëzuar një certifikatë në formatin siç përcaktohet në shtojcën përkatëse. Pas lëshimit të certifikatës së plotësimit të Kushteve Paraprake nga blerësi, palët do të vazhdojnë mbylljen e Marrëveshjes.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i i prodhimit të energjisë hidrike ( nga uji), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Statkraft IH Holdings AS zotërohet 100% nga Grupi Statkraft, i cili është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

- Shoqëria Statkraft Renewables Albania SHPK, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e licensuar për prodhimin e energjisë nëpërmjet centraleve fotovoltaike me një kapacitet 2 MW dhe gjatë vitit 2021 ka gjeneruar 13 MWh duke zotëruar më pak se 0.1% në tregun e prodhimit të energjisë diellore.

- Shoqëria Devoll Hydropower SHA, është shoqëri aksionare me objekt planifikimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e njësisë prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar për afërsisht 319 MW në Luginën e Devollit nëpërmjet HEC-eve “Banjë” dhe “Moglicë”, të cilat kanë prodhuar gjatë vitit 2021 683 mijë MWh, duke zotëruar 8% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike nga uji.

Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. është një SPV e krijuar nga Gammon Group në vitin 2005, me qëllim ndërtimin e një projekti të prodhimit të energjisë hidrike në lumin Rimbi Khola në Sikkim (Veri-Lindje e Indisë).

Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri. Fokusi i tij është ndërtimi dhe operimi i projekteve hidrike dhe furnizimi me energji i konsumatorëve në Indi.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Sikkim Hydro Power Ventures Ltd. nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
2022**  
BULETINI ZYRTAR



2022